

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 16236/26

Nr. i fq. / Br. st. - 1 -

Data / Datum: 20.04.2026

VUSHTPRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 68/26 20/04/2026

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrië dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrië:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **30 prill 2026 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrië.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrië, mbajtur më datë 31 mars 2026;
2. Raport i shpenzimeve për periudhën janar – mars 2026;
3. Draft – Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrië;
4. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private në rr. “Ismail Parduži” në Vushtrri sipas gjendjes faktike;
5. Propozim – vendim për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (hartimin) e rregullores për punën e kuvendit.
6. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi
Kryesuese e Kuvendit të Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01. Nr. PB-56/26 30/04/2026

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 31 MARS 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në ora 10:30.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë si: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli – Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzi, Pëllumb Maliqi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- i nderuari nënkryetar i komunës, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të mediave të shoqërisë civile, përfaqësues të MAPL-së, të dashur qytetarë të komunës së Vushtrrisë, jemi sot në mbledhjen e rregullt të muajit mars. Fillimisht konstatoj që të pranishëm janë 30 anëtarë të Kuvendit. Mungon për momentin vetëm Behar Duraku i cili na ka njoftuar se vjen ndërkohë. Kur jemi tek kuorumi edhe në këtë seancë duhet ta përmendim rastin e Ramadan Parduzi i cili është duke punuar në arsim njëkohësisht edhe anëtar i kuvendit e që sipas ligjit duhet të zgjedhë njërën prej këtyre detyrave kështu që po kërkoj dhe njëherë prej Ramadanit që të merr vendim se cilën rrugë, me e zgjedh rrugën sikur të gjithë punëtorët e arsimit që jemi këtu që e kemi marrë këtë veprim. Gjithashtu edhe prej sekretarisë po kërkoj që kur numërohen votat me pas kujdes që mos me na i rreziku ligjshmërinë e vendimeve. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, materialin e keni marrë me kohë. Në Komitetin për Politikë e Financa e kemi pasur edhe një pikë të rendit të ditës e cila sot e keni marrë me kohë menjëherë në email adresat tuaja është pika nga Drejtoria e Arsimit, Propozim vendim për komisionin për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të cilën do ta shqyrtojmë sot. Ndërsa pa kaluar në Komitetin për Politikë e Financa, ka ardhur edhe një

kërkesë tjetër për botimin e një libri të cilën me kërkesë të kryetarit e tërheqim prej rendit të ditë, dhe kërkoj që të shkojë edhe kjo lëndë në drejtorinë përkatëse të shqyrtohet, të vlerësohet e pastaj të vjen në kuvend sipas ligjit sikur çdo ë çështje tjetër. Prandaj të nderuar anëtarë të Kuvendit do të diskutojmë shtesë vetëm për pikën për komisionin për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve si pikë shtesë për këtë seancë të sotme.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para qytetarëve dhe Kuvendit të Komunës, deklaroi se: në fakt një email e ka dërguar te Kryetari i Komunës dhe shtoi se në qoftë se keni një Republikë në Kosovë dhe një shtet duhet me qenë të barabartë të gjithë. Mitrovica është në kuadër të shtetit tonë dhe atje e njëjta zyrtare është profesoreshë, punon në arsim, punon në asamble edhe është në KPF, e merr 50% e pagës së KPF-së. Në qoftë se kjo është kështu atëherë në republikë dhe në shtetin tonë duhet me qenë të barabartë të gjithë. E dyta, njëjtë është vepruar edhe në komunat Podujevë, Rahovec dhe Malishevë, ju është ruajtur vendi i punës secilit anëtar të kuvendit edhe Drejtoria e Arsimit në Vushtrri e ka obligative që të veproi në ruajtjen e këtyre vendeve të punës të mësimdhënësve, se nuk është e lehtë që 25 vite punon në arsim dhe tani të jap dorëheqje te nxënësit dhe sqaroj se punon si anëtarë i kuvendit. Asnjë pagë nuk e kam marrë në kuvend, në asnjë komision nuk është kompensuar. E vetmja pagë e tij është profesor ku punon. Është dashur edhe si komunë edhe Drejtoria e Arsimit, nga ministria të kërkojë të gjendet një zgjidhje për këtë çështje.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- diskutimi i saj përqendrohet tek ajo që po bëhet për tri seancat paraprake dhe po ashtu pajtohet që nuk do të ishte dashur të vinim në këtë situatë. Po për të mirën e vendimeve, për të mirën e qytetarëve unë si kryesuese e kuvendit e ndjej obligim ligjor me kërkuar edhe prej Ramadanit dhe prej të gjitha instancave që të zbatohet Ligji për Zyrtar Publik për të gjithë njëjtë, edhe brenda kuvendit tonë të njëjtë edhe në komuna të tjera se nuk duhet me u punuar me standarde të dyfishta. Megjithatë përsëriti se qëndron në atë që duhet të kemi kujdes në marrjen e vendimeve në dy seancat paraprake nuk kemi pasur çështje që ka qenë vota juaj vendimtare, por megjithatë edhe sot do të jemi të kujdesshëm.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit- tha se dëshiron t'i ngritë dy çështje. E para ka të bëjë me sheshin ku qytetarët po pyesin se çfarë është duke u punuar në shesh? A është vazhdim i projektit nga sheshi te parkingu apo është një projekt i ri. Nuk e di pse fokusi i kësaj qeverie duhet të jetë vetëm sheshi. Thuajse Vushtrria nuk ka problematika të tjera? Si është e mundur nënkryetar a mendon se është duke u punuar mirë në shesh dhe a është puna transparente pasi që nuk po shohim një tabelë të projektit do kishte qenë mirë të na jepen këto informata. Ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me urën e Nadakocit që ju kanë dëmtuar mbajtësit e urës dhe paraqet rrezik për bujqit që kalojnë me makineri të rënda dhe ata po presin një përgjigje nga komuna nëse kjo do të rregullohet. Këtu i ka edhe fotot që ia kanë dërguar ku shihet qartë se si ka rënë mbajtësja e urës edhe nuk po mundën me kaluar sidomos në këtë periudhë ku është shumë e nevojshme për tokat bujqësore që fillon koha e mbjelljeve pranverore.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para qytetarëve dhe Kuvendit të Komunës, deklaroi se: fillimisht duke iu adresuar kryesuese me një sugjerim që kur fillon kjo pjesa e debatit në fillim është mirë me respektuar një farë rregulli të pashkruar por që mendoj që është mirë kur t'i jepet fjala fillimisht t' jepet fjala shefave të grupeve duke filluar nga partia më e madhe edhe të vazhdojnë tutje e mandej kush ka me diskutuar diçka tjetër le të diskuton le të jetë një farë si kjo rregull kështu. Më tej ngriti disa çështje ndër to çështja e parë është parkingu nëntokësor, ku e dimë që ka kushtuar diku 3 milion e diçka bashkë me atë pjesën përmbi, mirëpo shfrytëzimi i tij është minimal. Kushdo që kalon nga parkingu e sheh që minimum çdo kohë në çdo moment i ke 70 vende të lirë. Kjo i bie që ai parking që është ndërtuar me paratë tona dhe që ka kushtuar

jashtëzakonisht shumë nuk është duke u shfrytëzuar nga qytetarët. Kërkoj prej atyre që janë kompetent për këtë qasje që të rishqyrtohet vendimi ose mënyra e shfrytëzimit të tij në mënyrë që ky parking të shfrytëzohet sa më shumë për qytetarët. Po shohim të gjitha veturat janë nëpër rrugë a parkingu është i pashfrytëzuar. Domethënë duhet të ndërmerret diçka që ai të jetë i shfrytëzueshëm. Pika e dytë në mbledhjen e kaluar ne bëmë disa pyetje Drejtorit të Urbanizmit kur kryetari nuk ishte këtu. Janë tre pyetje, që nuk kemi marrë përgjigje njëra prej tyre është rasti tek ndërtesa tek Lllamarina. Është një përgjigje shumë e sinqertë, por që na jep me kuptuar që këtu nuk është duke funksionuar asgjë. Kur drejtori u pyet për objektin tek Lllamarina, i ndërtuar në anën e djathtë si të kalohet rrethi ai tha kështu, për atë objekt as nuk është kërkuar leje e as nuk ka leje. Po ai objekt është ndërtuar edhe askush asnjë masë nuk është ndërmarrë. Pyetja është tash këtu a ka shkuar inspektorati menjëherë? pyetje për Drejtorin e Inspektoratit? Çfarë ka ndërmarrë inspektorati për këtë punë? A jeni marrë vesh me të me punuar në heshtje apo çfarë është puna? Pyetja tjetër, në vitin e kaluar ne e kemi marrë një vendim këtu si kuvend për ndërrim prone me objektin që është i ndërtuar në rrugën “Ismajl Qemajli”, pyetja jonë është kjo? A është ndërruar prona edhe cila pronë me të cilën është ndërruar edhe sa është ndërruar? Neve na duhet një raport i detajuar nga Drejtoria e Kadastrit që të dimë saktësisht se cila pjesë është marrë edhe cila pjesë është dhënë nëse na është dhënë neve si komunë. Çështja tjetër që e kemi ngritur disa herë është hapja e një grupe për ndërtimin e një ndërtese që nuk është bërë kurrë e që paraqet rrezik për qytetarët atje. Cilat janë hapat që i ka marrë kryetari gjegjësisht qeveria për këtë çështje? Një problem tjetër që po na përsëritet me vite, me vite kurrë nuk ndal është objektet që po ndërtohen nënkryetarë ata po hapin, po prishin rrugën për me e bë kyçen në ujësjellës ose në kanalizim edhe po qëndrojnë të hapura me muaj edhe me vite pa i mbyllur askush edhe po paraqesim pengesë për lëvizjen e qytetarëve. Deri kur do t'i tolerojmë që një objekt që kushton miliona euro mos me sanuar një rrugë që kushton 200 apo 300 €.

Hava Mlinaku, anëtare e kuvendit- kërkoj sqarim për gjithë opinionin publik në lidhje me projektin i cili është bashkëfinancim i Komunës së Vushtrrisë me Islamik Relievi, vizitat shtëpiake paliative është projekt i cili përfundon ose vazhdon ose jo në mungesë të buxhetit. Shumë qytetarë e kanë ngritur këtë shqetësim sepse kryhen vizita në shtëpitë e tyre edhe në viset më të larta rurale nga ekipe të islamik relief që janë diku rreth 24 persona që punojnë aty. A ka rrezik mos me u vazhduar ky projekt apo po mendohet me u vazhduar? Kini parasysh që aty thashë punojnë rreth 24 punonjës, prej tyre shtatë janë mjekë dhe të tjerët janë infermierë. Edhe në bazë të raportit të fundit nga Drejtoria e Shëndetësisë, këta këto ekipe arrijnë me i bërë nga 2000 deri në 4.000 vizita shtëpiake brenda muajit. Domethënë është një projekt që ka impakt shumë të madh tek qytetarët e Vushtrrisë. Kështu që do të ishte shumë me rëndësi me u vazhduar. Po ashtu një tjetër shqetësim në lidhje me këtë projekt këta punonjës punojnë me pagë minimale dhe nuk gëzojnë asnjë drejtë asnjë beneficion nga thesari kështu që do të ishte mirë që në vazhdimin e projektit gjatë viteve të ardhshme të kihet parasysh edhe paga e këtyre punonjësve. Një tjetër problem që e ka vërejtur gjatë këtyre ditëve është trotuari tek parku i qytetit, rrugën ngjitur me parkun e qytetit, ku sigurisht gjatë punës në park është dëmtuar shumë ai trotuar. Domethënë ai është diku një vit e gjysëm që është përruruar. Po prej makinerive të rënda si duket aty është dëmtuar shumë edhe thuaj është sikur me u ndërtuar para 10 viteve, andaj kërkoj që të ndërmerren veprime për rralimin e këtij trotuari.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para qytetarëve dhe Kuvendit të Komunës, deklaroi : janë dy çështje të cilat dua t'i ngriti. Çështja e parë ka të bëjë me pikat e rendit të ditës të cilat na vijnë nga materiali që e kemi, por nga ajo që e kemi parë prej që ka filluar kjo legjislaturë, shihet që në secilën seancë na vijnë pika të për t'i rishqyrtuar vendimet që i

merr kuvendi komunal. Kjo për neve është shqetësuese sepse në secilën seancë pra kemi pika e rendit të ditës të cilat duhet të korrigjohen nga vendimet që merren. Sikur të mos ishte Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila e vlerëson ligjshmërinë e vendimeve që i merr kuvendi komunal sigurisht që përgjegjësia do të binte mbi ju kryesuese e kuvendit. Prandaj ju duhet ta falënderoni ministrinë që vazhdimisht kthen pikat e rendit të ditës dhe ai i ka analizuar këto dhe për fat mirë shihet që grupi kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje në të gjitha këto pika ka votuar <kundër> për shkak se kemi parë që kemi vendime të cilat janë në kundërshtim me ligjit. Veç po i ceku në seancën e marsit që jemi sot i kemi dy pika për rishqyrtim, seancën e muajit shkurt i kemi pasur një pikë, seancën e janarit tre pika, në seancën e jashtëzakonshme të dhjetorit i kemi pasur pesë pika për rishqyrtim. Pra kjo është shqetësuese sepse ju si kryesuese ose jeni në presion të qeverisë komunale të kryetarit ose nuk konsultoheni me Zyrën Juridike nëse e keni këtu sepse vendimet pra që po merren po i kthen MAPL-ja si të kundërligjshme. Kjo është çështja e parë që e ngriti. Dhe çështja e dytë është këto ditë ka marrë ankesa dhe kërkesa që ta shtrojë këtu në kuvendin komunal nga banorët e fshatit Druar për gjendjen në varrezat e fshatit, konkretisht lagjeve Bojku, Ibishi dhe Tahiri. Afër këtyre varrezave kalon kanalizimi i një pjese të fshatit, pjesës më të madhe të fshatit, i cili është bllokuar dhe në këto varreza pastaj ka shkaktuar vështirësi të mëdha, sepse i tërë kanalizimi është derdhur në këto varreza. Gjatë dy javëve që lamë pas, këto tre familje kanë pasur secila nga një rast vdekje dhe kanë pasur shumë vështirësi për kryerjen e ceremonisë së varrimit për shkak të situatës së krijuar nga grumbullimi i ujit të kanalizimit. Andaj kërkojmë nga organet kompetente komunale të merren masa dhe të sanohet gjendja e krijuar në këto varreza.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-sqaroi duke u përgjigjur për vendimet që po na vijjnë për pika që na vijjnë me u rishqyrtuar. Po të kish diskutuar një anëtar i ri i kuvendit. S' më kish ardhur fort çudi. Po në çdo mandat i kemi pasur këto rishqyrtime të pikave të rendit të ditës. Është mirë të jemi të gjithë bashkë koshientë e të kemi sa më pak vendime të tilla. Të gjitha organet edhe kuvendi kanë organe të tjera që e mbikëqyrin e monitorojnë edhe e vlerësojnë edhe ligjshmërinë edhe zbatueshmërinë e vendime të tyre. Megjithatë vendimet nuk i merr kryesuesja, e kuvendit vendimet i marrim kuvendi. Prandaj jam e mendimit që me pas sa më pak vendime në rishqyrtim, por edhe do të ketë në këtë mandat edhe në mandate tjera sepse kjo është puna e kuvendit.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit- e nderuar kryesuese, nënkryetarë, drejtor, kolegë të nderuar, po marr fjalën si rezultat i shqetësimeve të vazhdueshme të qytetarëve të cilët në mënyrë të përsëritur më janë drejtuar me një problem serioz në rrugën “Hasan Prishtina”. Bëhet fjalë për uzurpimin të trotuarit në biznese të caktuara të cilët jo vetëm që kanë zënë hapësirën publike, por edhe e kanë shpenzuar në mënyrë që të duket si parking duke shfrytëzuar për parking të veturave. Si pasojë e kësaj gjendje, qytetarët përfshirë fëmijë të moshuar dhe persona me nevoja të veçanta detyrohen të ecin në rrugë duke rrezikuar drejtpërdrejt sigurinë e tyre. Kjo situatë është e papranueshme dhe nuk duhet të tolerohet më tej. Prandaj kërkoj nga Drejtoria e Inspektimeve të ndërmarra masa e menjëhershme për lirimin e trotuarit dhe kthimin e tij në funksion për këmbësor, të ndaloj shfrytëzimin e paligjshëm të hapësirës publike për biznes nga bizneset. Por nëse ekziston ndonjë vendim komunal që lejohen praktikë të tillë të na informojë në mënyrë të qartë dhe transparente. Ky trotuar, e di që është para se me ardhur qeverisja e Ferit Idrizit. Prandaj kërkoj nga drejtoria përgjegjëse që nëse ka ndonjë vendim mendoj që është i paligjshëm nëse ka marrë ndonjë vendim të tillë ta shfuqizoj. Tutje ka edhe një shqetësim edhe një kërkesë nga bujqit të cilët kanë pas vlerësimit të dëmeve që ka bërë komuna dhe ata janë shqetësuar janë konfuz në lidhje me përgjegjësinë kush me siguruar mjetet me kompensuar dëmin.

Prandaj kërkoj edhe nga Drejtoria e Bujqësisë që t'i informojë qytetarët zyrtarisht sepse ne e bëjmë si e di unë që jam i informuar komuna bën vlerësimin e dëmit por Ministria e Bujqësisë nuk i ka alokuar mjetet. Prandaj kisha kërkuar edhe një sqarim prej Drejtorit të Bujqësisë sepse janë fermerë ata që janë dëmtuar nga dëmet natyrore prandaj kisha kërkuar një sqarim për këta qytetarë. Po ashtu ai sqaroi se Ligji për Zyrtarët Publik, është shumë i qartë, ku ka pacaktuar se cilën pozitë duhet ta mbaj ai që është zgjedhur si anëtarë i kuvendit që njëra pozitë duhet të pezullohet dhe kështu ka vepruar në rastin e tij Komuna e Mitrovicës ku ai punon.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- në adresimin e saj para qytetarëve dhe Kuvendit të Komunës, deklaroi: sot para jush dëshiroj të ngriti disa çështje. Çështja e parë kryesuese që dua me ngrit ka të bëjë me një vendim i cili ka kaluar në Komitetin për Politikë e Financa në muajin gusht të vitit të kaluar. Çështja është propozim vendim për mbështetje financiare për z. Ilir Planën, punëtor i komunës ai propozim ka kaluar në Komitet si pikë e rendit të ditës dhe ka ardhur në seancën e rregull të mbajtur më 23 gusht të vitit të kaluar në seancë nuk ka kaluar për shkak të kuorumit të pamjaftueshëm për aprovimin e këtij propozim, dhe ajo pikë e rendit të ditës më pas asnjëherë nuk është proceduar në seancat e radhës të Kuvendit komunal. Ligjërisht pikat të cilat kalojnë në Komitetin për Politikë e Financa duhet të vijnë edhe në seancat e rregullta të kuvendit komunal pavarësisht se në atë seancë nuk ka pasur kuorum. Ajo kërkesë tashmë është kthyer në Drejtorinë e Shëndetësisë. Andaj pyeti se a ka mundësi me na njoftuar kryesuese si ka rrjedhur kjo punë dhe si është kthyer prapë në Drejtorinë e Shëndetësisë kjo kërkesë. Çështja e dytë ka të bëjë me formimin e Grupit Joformal të Grave në kuvend sot para jush propozoj që ta themelojmë komisionin e grave joformal në kuvendin komunal të Vushtrrisë. Çështja tjetër ka të bëjë me një kërkesë direkt për Drejtorinë e Arsimit e cila kërkon mbështetje edhe nga kryetari dhe nënkryetari i komunës. Siç e dimë në javën e ardhshme shkollat e kanë pushimin pranveror. Kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që në javën e ardhshme të merr një vendim dhe t'i dërgojë në pushim edhe çerdhet publike që janë tri në komunën tonë për arsye se janë vetëm tre ditë pune në javën e ardhshme. Dy ditë janë festa zyrtare domethënë e hënë dhe e premte janë festa zyrtare ndërsa tre ditët janë të punës. Po besoj që të gjithë prindërit që kanë fëmijën e çerdhe duke i njohur edhe shumicën nga prindërit nuk do ta shohim këtë punë si çështje që nuk mund me i bë zgjedhje fëmijëve, është kërkesë dhe është diskriminim ndaj edukatorëve të cilat punojnë në shkolla që e kanë pushimin pranveror, e gëzojnë pushimin pranveror, vjeshtor, dimëror, ndërsa edukatorët e çerdheve e gëzojnë vetëm një muaj apo më mirë me thënë tre javë në pushim në verë. Kërkoj mbështetje nga ju si qeverisje komunale dhe nga Drejtoria e Arsimit. Udhëzimi Administrativ nuk e specifikon, as nuk e ndalon dhe as nuk e lejon pushimin pranveror, vjeshtor dhe dimëror për çerdhet publike.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-sqaroi me sa vijon: çështja e z. Ilir Pllana, kërkesa e tij ka ardhur në korrik, është shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, ka hyrë në rendin e ditës, edhe në seancën e kuvendit, mirëpo seanca është ndërprerë për shkak të mungesës së kuorumit. Seanca është ndërprerë jo vetëm për këtë pikë, por për të gjitha pikat të tjera që kanë mbetur. Bile Vetëvendosja ka qenë ajo që s'ka marrë pjesë në seancë. Mirëpo të gjitha pikat që kanë mbetur prej asaj seance po veç ta cekim që është seancë e mandatit të kaluar. Prandaj të gjitha pikat që kanë mbetur prej asaj seance për të mos me mbet krejt pa u shqyrtuar i kemi drejtuar nëpër drejtorin se nuk është vetëm kërkesa në fjalë. Më tej sqaroi përpjekjen që e ka pasur për kërkesën e Ilirit edhe për disa të tjera ka biseduar me kryetarin dhe sipas ligjit i kemi drejtuar në drejtorinë përkatëse. Presim prej Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Buxhetit me i vlerësuar ato kërkesa dhe me i sjellë gjatë këtij mandati për shqyrtim. Ndërsa sa i përket Grupit të Grave, kemi biseduar shpesh ne gratë për këtë çështje. Nuk kemi qenë fort dakord për këto

ndarjet burrë grua. Po megjithatë Drejtoresha e Administratës e propozoj në atë takimin që ishim bashkë me END. Prandaj edhe në bazë të kërkesës ose propozimit të drejtoreshës edhe të propozimit të dhënë sot unë po kërkoj prej Sekretarisë së Kuvendit që të hyjë sot në procesverbal që mund ta formojmë këtë grup. E formojmë sot pa problem grupin e grave. Jo, grupi joformal të grave s'ka nevojë as me qenë pikë e veçantë rendit i ditës apo diçka tjetër. E formojmë ne në një kohë të përshtatshme sot ose deri në seancën e ardhshme.

Gresa, Muli, anëtare e kuvendit- në adresimin e saj para qytetarëve dhe Kuvendit të Komunës, deklaroi: para se me diskutuar për çështjen që dola për me fol, po dua me cek për Grupin Joformal të Grave se kam goxha përvojë nga mandati im i parë 2017/2021 kam qenë kryetare e Grupit Joformal të Grave. Kemi pasur vështirësi për ta formuar atë kohë për shkak sepse ka edhe hezitime se nuk ka ndonjë fond të veçantë prej komunës që i ndahet domethënë mjete financiare, por gjithçka duhet me u bë prej vullnetit të lirë të secilës prej nesh. Atë kohë nëse nuk gaboj ka qenë OSBE-ja iniciatori i grupit jo formal të formimit të grupit. Asaj i ishte besuar pozita e kryetares së grupit. Në atë kohë ka pasur projektet shumë të mira të cilat kam aplikuar për grantin e për organizata të ndryshme të cilat kanë japë grante për çështje të ndryshme. Po prej komunës nuk kemi pasur ndonjë mbështetje. Sigurisht se nuk ka ndonjë plan, nuk ka ndonjë linjë të veçantë për ndarje të mjeteve. Po edhe gatishmëria e grave në atë kohë të kuvendit nuk ka qenë aspak e kënaqshme për me bërë gjëra të mira për gratë e komunës së Vushtrrisë. Kështu që edhe unë mendoj që është shumë mirë me u formuar ky grup sepse në atë kohë patëm bërë shumë gjëra të mira por duhet me pasur edhe vullneti secila dhe me gjet pak kohë të lirë që vullnetarisht pa pagesë me bërë gjëra të mira për komunitetin për gratë sidomos për gratë në zonat rurale. Në atë kohë jam krenare që falë grupit me të cilin e kam udhëheq dhe falë grantit që e kemi fituar kanë arrit 52 gra me i ndjek trajnimet gratë të zonave rurale dhe gratë të komuniteteve të huaja për përpunimin e qumështit për përpunimin e brumit ju kemi organizuar edhe panair për me i shit gjërat e tyre kështu që ato kanë certifikatë dhe tash sa herë të mbahen panair janë të gatshme për me i shit produktet e tyre edhe me hy në treg. Për sa i përket çështjes tjetër, pra për gratë, së pari ju e vlerësoj që e keni rinovuar objektin ku kanë qenë shoqatat edhe sinqerisht ka pasur shumë nevojë sepse ka qenë shumë e pahijshme kur kemi kaluar andej edhe kur kemi hy brenda ka kundërmuar erë e keqe. Zyrat janë kanë në gjendje të keqe dhe ka pasur shumë nevojë me u rinovuar ai objekt. Po çka mua më ka bërë përshtypje është që besoj që krejt e dini që në komunën e Vushtrrisë ka herë është veç një OJQ e grave është organizata “ATO” kam shumë respekt për zonjën Fikrie edhe pse tash është pak më shumë në moshë edhe nuk e ka as kohën as forcën për me bërë vazhdimisht gjëra të mira për këtë kategori. Me forcat e saj vazhdimisht është mundu me marrë pjesë në projekte të ndryshme në sfera të ndryshme për me ju ndihmuar grave të Vushtrrisë. Zonja në fjalë sa e di unë dhe organizata “ATO” e ka pas zyrën ato ka herë dhe kur është rinovuar tash objekti ja kanë larguar inventarin nuk e di as ku ja kanë lënë edhe vazhdimisht është tu bërë kërkesa për me ja siguruar një hapësirë aty për me operuar po nuk merr përgjigje as nga kryetari as nga nënkryetari dhe as nga Drejtoria e Administratës. Nuk mendoj që është mirë që të vetmen OJQ të grave që e ka Vushtria me e eliminua në këtë mënyrë sepse kemi nevojë për më shumë, hapësirë për gratë e lë me e lënë anash. Kështu që ju lutem merreni parasysh edhe kërkesat e saj që i ka bërë me shkrim edhe kërkesën time përmes foltores së kuvendit që me ja krijua një hapësirë zonjës Fikrie.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit-pasi i përsëndeti të gjithë të pranishmit deklaroi: të gjitha diskutimet qenë me vend edhe i përsëndes kolegët e asamblesë. Unë e vij prej një rrafshi pak më sportiv edhe ditëve të fundit kam pas shumë thirrje prej njerëzve që përfaqësojnë sportin e Vushtrrisë. Klubet e sportit të Vushtrrisë janë në gjendje jo të mirë, kanë nevojë për mbështetjen e

komunës dhe mbështetjen tonë. Sidomos një problem i madh është me klubin e futbollit të qytetit, klub që secili prej neve jeni rritur duke e mbështetur dhe e tash po kalon në një periudhë jo të mirë financiare e krenjt kjo është për dhimbte se klubi në vitet e fundit asnjëherë nuk ka qenë më afër inkuadrimit në super ligë kështu që po kërkoj prej të gjithëve neve, prej kryetarit, prej Drejtoreshës së Kulturës dhe Sport që sa më shpejt të ndërmarrim diçka edhe klubeve sportit ju dalë ndihmë posaçërisht është më urgjente në klubin e futbollit Vushtrrisë. Ka edhe disa shqetësime mirëpo për mos me marrë kohë po dua me adresua se më kanë ardhur shumë thirrje prej miqve që përfaqësojnë sportin në Vushtri.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit-përshtendetje për të gjithë, e nderuar kryesuese, nënkryetar, unë dua me u ndalë për një çështje që besoj se të gjithë i kemi në emailat tona zyrtare që nga Asociacioni i Komunave duke parë që jemi anëtarë të rinj të kuvendit dhe është filluar cikli i trajnimeve për anëtarë është me që me datën 3 prill nga ora 10:00 do bëhet një trajnim për neve si anëtarë të kuvendit. Ky trajnim do të mbahet në Ferizaj kështu që propozoj si anëtarëve të Kuvendit të kenë transport të organizuar që ne të paktën anëtarët e rinj të Kuvendit të jenë pjesë e këtij cikli trajnim dhe të jemi të mirë informuar mbi punën e Kuvendit komunal.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- kërkoj nga kuvendi, kryesuesja dhe nga kryetari këtu të bëhet një komision për Sport, Kulturë Rinia dhe Sport në kuadër të kuvendit që kur ndahen mjetet, subvencionet, ky komision do të ketë rolë ad-hoc ashtu që kuvendi të ketë qasje dhe të jetë i përfshirë në ndarjen e këtyre subvencioneve.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-përshtendetje për të gjithë anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të shoqërisë civile, të mediave, të gjithë të pranishëm, të nderuar qytetarë. Faleminderit prej secilit prej juve për punën, angazhimin edhe të gjitha shqetësimet që keni ngritur sa i përket çështjeve që u diskutuan në fillim të seancës së Kuvendit. Sa i përket anëtarit të kuvendit z. Ramadan Parduzi, ndoshta veç u sqarua ajo pjesë, ne e biseduum me të paraparakisht para seancës. Ai vlerësoi se edhe për ata nuk është e lehtë të merret një vendim sepse në fund të fundit Zyrtari Kryesor Administrativ është ai që merr vendimet për pezullime të vendeve të punës. Këtë ia lejon Ligji për Shërbyesit Publik. Ngjashëm me ta është vepruar edhe me Mentor Hasanin i cili është anëtari i Partisë Demokratike, Melihate Bashollin e cila është kryesuese e kuvendit, Refik Malokun, Fatmire Cecelia, Ymer Haradinaj, Fakte Dushi, si dhe rasti i ngjashëm është z. Mentor Ferizi i cili jepi sqarimin e tij që punon në komunën e Mitrovicës është poashtu edhe z. Behar Duraku, tash ndoshta po e harroj dikë prej anëtarëve të kuvendit i kërkoj falje mirëpo në atë aspektin që edhe ne jemi të obliguar së pari ta respektojmë ligjin, mirëpo edhe parimi i diskriminimit nuk bën të vlejë për asnjë prej neve. Kështu që nëse anëtari i kuvendit z. Ramadan Parduzi, nuk vepron sigurisht që ne kemi me kërkuar prapë edhe një opinion ligjor dhe si qeveri komunale do ta marrim një veprim sepse edhe për neve ndoshta do të jetë konsumimi i veprës penale mosveprimit në këtë rast nga ana e kryetarit të komunës. Për sa i përket znj. Leonora Gërguri që e ngriti çështjen e sheshit, rregullim i kubzave më tej në sheshin "Adem Jashari" është vazhdimësi e projektit, ka qenë i miratuar nëse s'gaboj në vitin 2024 dhe është vazhdimësi. Ky projekt do të përmbillet sivjet. Është njëri prej projekteve më të mira që e kemi bërë në mandatin e kaluar dhe që po vazhdon këtë mandat. Sigurisht ka qenë edhe njëri prej projekteve që i ka fituar zgjedhjet e vitit të kaluar, kështu që po besoj që ka me qenë njëri prej projekteve më të mira. Normalisht që ka qenë transparent sepse vetë procedura e prokurimit edhe të gjitha kanë qenë transparente dhe të hapur. Për sa i përket tabelës, unë e ftoj Drejtorinë e Inspektoratit sepse për secilin projekt secila kompani qoftë në investim publik apo privat është e obliguar që ta vendosë tabelën sa i përket investimit që bën në komunën tonë. Ura në fshatin Nedakoc është me vendim e mbyllur sepse është e pakalueshme. Tash një pjesë ndoshta dikush aty kalon

edhe rrezikon, mirëpo unë sa e di ka vendim për atë pjesë që është e ndaluar dhe sigurisht aty ka nevojë shumë që të ndërtohet një urë e re. Sigurisht do të vjen në seancë në këtë vit me projekt buxhet dhe në vitin e ardhshëm do të ndërtohet ura e re. Puna e parkingut, që e ceku profesor Refik Maloku, ke të drejtë, ndoshta nuk është duke u shfrytëzuar në mënyrën më të mirë të mundshme, mirëpo duhet me pas parasysh që shumica absolute apo të gjitha parkingjet që janë publike në rrugët e qytetit janë për momentin pa pagesë. Rregullorja është në draft, është në hartim. Sigurisht në seancën e ardhshme do të vjen për aprovim. Ka nevojë që qyteti të vihet në rend. Është mirë me pas pagesë në mënyrë që të shfrytëzohen edhe parkingjet publike, mirëpo edhe ato private. Sigurisht që kjo ndoshta ka me qenë njëra prej arsyeve që veç nuk po ka shfrytëzim në atë pjesë. Sa i përket ndërtesës tek fabrika e Lllamarinës dhe të gjitha ndërtesave të tjera është Drejtoria e Inspektoratit që i mbikëqyr ndërtimet. Ne sigurisht që këtë shqetësim do ta drejtojmë në Drejtorinë e Inspektoratit dhe është e obligueshme që për secilin ndërtim që është pa leje të merren masat ndaj kujtdo qoftë. Ndërrimi i pronës tek rruga “Ismajl Qemajli” për këtë kërkoj prej Drejtorisë së Kadastrit, edhe prej Drejtorisë së Urbanizmit që në seancën e radhës të bëjë një raport detaj para anëtarëve të Kuvendit dhe para të gjithëve në mënyrë që të grafkohet në një farë forme se cila pjesë është ndërruar me pronarin, cila pjesë i takon tash komunës, si është dhënë leja dhe a është jep sipas Ligjit për Ndërtim. Lidhu me çështjen e ngritur nga anëtarja e kuvendit znj. Hava Mlinaku projekti me bashkëfinancim e Islamic Reliefin, ky projekt është deri në muajin qershor ka marrëveshje, dhe qytetarët nuk do të mbesin pa shërbime të njëjta, shërbime do të kryhen ne jemi në bisedime me Islamic reliefin mirëpo sipas tyre problemi është tek ata për shkak të fondeve të tyre që janë më të kufizuara sesa vitet e kaluara, mirëpo qytetarët do t'i marrin ato shërbime pavarësisht se a do jetë të Islamiku apo me fond tonë të komunës edhe ata punëtorë po shpresojmë shumë që nuk do të mbesin pa punë ashtu qysh kanë punuar me vitet të tëra, ndoshta prej vitit 2011. Sa i përket trotuarit Drejtoria e Shërbimeve Publike e shikon cili rast është tek parku i qytetit, dhe sigurisht do të intervenohet me kohë. Pastaj lidhur me vërejtjet e profesorit Ymer Haradinaj veç ju përgjigj kryesuesja sa i përket vendimeve të kuvendit. Ndërsa gjendja e varrezave në fshatin Druar, ke të drejtë, sepse ai ka qenë prezent në një varrim në atë fshatë, dhe me të vërtetë gjendja ishte jo e mirë që secili prej neve duhet me u ndje keq edhe ka biseduar bashkë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe po besoj që shumë shpejt do të intervenohet në atë pjesë sepse nuk është çështje që e meriton me mbet në atë gjendje. Tek anëtarja e kuvendit znj. Gresa Muli e cila ka të drejtë, ku njoftoj se ka biseduar personalisht në zonën Fikrije përfaquese e organizatës “Ato”. E dimë që objekti që ka qenë tek shoqatat që i kemi thënë të gjithë ka pas hapësira më shumë në mandatin e kaluar, mirëpo siç e dimë pas renovimit një pjesë e madhe domethënë pjesa më 50% e sipërfaqes së saj tashmë është vendosur Drejtoria e Inspektoratit. Për këtë jemi duke biseduar me KQZ-në sepse njëra prej zyrave ku është e lirë aty është e dedikuar për KQZ-në, mirëpo jemi duke kërkuar prej tyre që me gjet një hapësirë tjetër edhe po besoj shumë shpejt që zonjës Fikrije dhe shoqata “ATO” do të vendosen prapë në atë zyrën ku është e lirë në atë objekt. Më tej shtoj se gjendja financiare e klubeve e dimë që nuk është e mirë. Kryetari bashkërisht me neve dhe një pjesë të asamblistëve jemi munduar që përmes donatorëve të sigurojmë mjetet për të gjitha klubet sportive që janë në komunën e Vushtrrisë. E dimë që gjendja e klubit të futbollit nuk është e mirë. Jemi në përpjekje të vazhdueshme që të gjejmë donatorë sepse e dimë që buxheti i komunës nuk është i mjaftueshëm për situatën e cila është krijuar në klub edhe për gjendjen të cilën duhet me qenë në të ardhmen klubi. Nuk është komuna që mundet ndoshta deri në fund me mbështet financiarisht. Ne kemi parë të gjitha alternativat që i kemi prej buxhetit të komunës edhe për klube të tjera. Po ky vit do të jetë goxha vit i vështirë financiar edhe nuk është që kemi me pas lehtë me tejkaluar. Lidhur me transportin për secilin anëtar të kuvendit në qoftë se

ka trajnim jashtë Vushtrrisë do ta sigurojmë transportin e organizuar konform numrit që do të jetë prezentë atje në atë trajnim.

Në vazhdim kuvendi, pas votimit me 18 vota “për” aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim-vendim për emërimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Vushtrrisë;

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- propozoj të futet në rend të ditës si pikë e veçantë, propozimi për mbështetje financiare për fëmijët me nevoja të veçanta, për fëmijët të cilët janë të prekur me autizëm dhe me sindrom Daun. Kërkoj mbështetjen e juve si qeverisje komunale dhe kërkoj nga kolegët e asamblesë që të mendojnë me qetësi dhe ta votojmë këtë propozim fillimisht me hy në rendin e ditës e pastaj me u votuar dhe aprovuar në tërësi, që çdo fëmijë që është në komunën tonë i prekur me sindrom daun dhe me autizëm t'i ndahen çdo muaj nga 100€ si mjete financiare nga subvencionet. Është një shumë simbolike, mirëpo mendoj që prindërve që ballafaqohen çdo ditë me kërkesat dhe nevojat e fëmijëve të tyre që i kanë të prekur është një ndihmesë e vogël. Kështu që ju lus edhe njëherë të dashur kolegë që ta votoni këtë propozim, të futet në rend të ditës dhe pastaj si pikë të kalojë. Nuk është një shumë e madhe e mjete financiare, këtu kërkohet vetëm evidenca se sa fëmijë janë në komunën tonë të prekur me autizëm dhe sindrom Daun, nga Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Uroj që mos kemi shumë fëmijë të prekur në komunën tonë.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-sigurisht që askush nuk është kundër që të përkrahet një kategori kaq e veçantë. Mirëpo ne e dimë qysh është gjendja financiare së pari në komunë. Mirëpo kur bëhet fjalë për kërkesa për mbështetjet financiare të kategorive, unë kisha kërkuar prej juve që me të vërtetë më së pari të diskutohet në mesin e subjekteve politike dhe drejtorisë përkatëse në mënyrë që mos të bëjmë politikë në njëfarë forme me këtë kategori sepse nuk është e dinjëtetshme. Nuk është e moralshme. Edhe unë e kërkoj që të përkrahet mbasi veç erdh si pikë e rendit të ditës sepse secili prej juve keni me ndje keq nëse nuk votoni edhe duhet me votuar edhe kemi me votuar, sepse nuk keni për të na qitur asnjëherë keq, as me na lajthitur në këtë mënyrë. Edhe kemi me kërkuar mbas kësaj pike të rendit të ditës, mbasi që të votohet, unë kërkoj prej secilit anëtar të kuvendit që t' i drejtohet me MAPL-së, me shkresë në mënyrë që secilin vendim dhe secilin propozim që të merret nga ana e kuvendit të merret në mënyrë të njëjtë, mënyrë të ngjashme. Jo propozimet që vijnë prej subjekteve të ndryshme politike që nuk e kanë pushtetin në nivel qendror të anulohen atje për shkak të procedurave të Komitetit për Politikë Financa, që nuk janë anuluar asnjëherë në mandatet e kaluara. Mirëpo unë prej kabinetit, prej kryetarit të komunës unë e mbështes këtë pikë edhe sigurisht që secili subjekt e mbështet edhe jo subjekt, por s'ka anëtar i kuvendit që të del edhe sot voton kundër.

Pas debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për” 1 votë “abstenim” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shkurt 2026;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2026;

3. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2025;
4. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/2026;
5. Raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm;
6. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2025;
7. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete;
8. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, lidhur publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026;
9. Propozim-vendim për emërimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Vushtrrisë;
10. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shkurt 2026;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 25 vota “për” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shkurt 2026.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2026;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 27 vota “për” miratoi Procesverbalin nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2026.

3. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2025;

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- tha se dëshiron të potencon, dy pika, që i konsideron që janë goxha shqetësuese tek Drejtoria e Arsimit suksesi i gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025-2026 tek përqindje që është dallimi i suksesit të shkëlqyeshëm në klasën e 10 ndoshta s'po di a me thënë me i bë rekomandim Drejtorisë së Arsimit tek faqja 32 nga 100, suksesi përqindja e suksesit të shkëlqyeshëm tek klasa e 10 domethënë dallimi nga niveli fillor i lartë në shkollën e mesme klasa e 10 përqindje e nxënësve të shkëlqyeshëm është vetëm 4.55%.Për këtë dëshiron të di a ka menduar Drejtoria e Arsimit të bëjë një rishikim të mënyrës së mësimdhënies apo mënyrës së punës së vlerësimit në klasën e 10 për shkak se është një ndryshim i madh. Beson që kjo ka të bëjë edhe me orientimin në karrierë para se me shkuar në shkollën e mesme për shkak se sa e di unë nuk ka ndonjë mënyre ose ndonjë strategjie për me i orientuar nxënësit në karriere dhe për atë shumë nxënës shkojnë në një drejtim pa pasur një orientim të saktë. Po falë këshillave që ka pasur ka menduar që nxënësit që shkojnë në shkenca natyrore janë më të mirë e më të suksesshëm. Kështu që edhe karrierën pas shkollës mesme më shumë e kam drejtuar në shkenca shoqërore sesa në ato natyrore. Po mendoj që kjo ka shumë rëndësi sepse nxënësit të cilët janë në shkollë fillore dhe nuk e duanë një drejtim më pas në klasën e 10 kur bëhet ai ndryshimi drastik kanë kesi rezultati të suksesit. Gjithashtu tek kontrolli mjekësor nëpër shkolla më ka lënë shumë përshtypje një përqindje e madhe gati 50% e nxënësve kanë nivel të ulët të shëndetit oral. Nuk e di se a është Drejtoria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit duke bërë ndonjë

ligjërata periodike për shëndetin oral sepse është një gjë shumë e rëndësishëm shumë probleme shëndetësore vijnë prej mos mirëmbajtës së shëndetit oral të duhur. Kështu që mendoj që kishte me qenë shumë me rëndësi që tash e tutje për shkak të shqetësimit për këtë përqindje me menduar me bërë ligjërata në kohë periodike për këtë çështje.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- tha se meqë jemi te raporti për situatën ekonomike, financiare dhe zbatimin e planeve investive për vitin 2025 siç e dimë të gjithë dhe i shohim çdo projektet dhe situatën e komunës së Vushtrrisë. Tutje ajo kërkoj nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në mbledhjen e radhës të sjellë një raport të detajuar se sa ka komuna borxh ndaj operatorëve ekonomikë sa ka obligime domethënë ndaj operatorëve ekonomikë dhe me na sjellë raportin e komplet obligimeve të komunës për vitin 2026-2027, pasi që siç dihet komuna e Vushtrrisë ka hy aq shumë në obligime që nuk mundet me i përballu as këtë vit as vitin e ardhshëm kërkoj nga Drejtoria e Financave që të na sjellë të detajuar raport në seancën e radhës.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit-tha se është shqetësuese mungesa e ekzekutivit në seancën e kuvendit, tutje duke ju referuar faqes 4 të raportit vlerësoi se bujqësia dhe blegtoia thotë të planifikuar 2.323.571.72 €, realizimi në vitin 2025 është 100%. A ka mundësi të na sqaroni kah kanë shkuar këto mjetet sepse 1500 fermerë në Vushtrri në vitin 2024 nuk janë paguar 2025 po ashtu nuk janë pagua, ndërsa nuk është bërë thirrja në vitin 2026. A ka mundësi me na sqaruar se këtu po thotë raporti 100% janë shpenzuar mjetet atë pare nëse kanë qenë të destinuar për bujqësi kush i ka marrë ato mjete po ju siguroj që asnjë prej 1535 fermerëve nuk kanë marrë pagesa për bujqësi nëse është Drejtoria për Bujqësi dhe janë 2 milion, kush i ka marrë ato para me na specifikuar kah kanë shkuar këto mjete. Po kërkoj se është shumë shqetësuese po mendoj që është raporti i manipuluar destinim është krejt diçka tjetër dhe mjetet kanë shkuar krejt në drejtim tjetër. Këtu po specifikohet borxhi edhe në raport pa dashur me definuar që janë specifikuar 834.000 € borxhe po mundohem me qenë pak më korrekt edhe ndaj njerëzve që secili prej tyre ne ushqehemi prej duarve të tyre. Prandaj mendoj se secili prej neve kemi obligim moral të jeni pak më korrekt me ta, më transparent dhe me ju dalë në ndihmë. Po kërkoj prej teje kryesues me marrë si iniciativë me ditë për shkak që as Drejtori i Bujqësisë, as nënkryetari, as dikush tjetër nuk janë këtu prezent për të na jap sqarimet e duhura dhe të nevojshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-duke ju adresuar kuvendit deklaroi: raporti për situatën ekonomike financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2025 tregon qartë për një dështim të qeverisë komunale dhe të kryetarit Ferit Idrizi. E tha kolegu pak më herët tek bujqësia. Objektivat kryesore thuhet këtu, për vitin 2025 janë rritja e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, mbështetja e fermerëve përveç subvencioneve dhe asistencës teknike dhe gjëra të tjera por, menjëherë në faqen tjetër tregohen obligimet të cilat komuna e Vushtrrisë i ka ndaj fermerëve për subvencionimin e qumështit. Ajo çka është shqetësuese është se Drejtoria e Bujqësisë në vitin 2025 pra ka pasur një buxhet për mbi 2 milion euro mirëpo problemi është që ky buxhet nuk ka shkuar tek fermerët dhe shihet qartë që komuna e Vushtrrisë respektivisht Drejtoria për Bujqësi bujqve dhe blegtorëve të Vushtrrisë ju ka mbetur borxh për subvencionimin e qumështit për vitet 2024 dhe 2025 e po ashtu duke ju referuar fjalëve të mëhershme që i tha nënkryetari i komunës se gjendja ekonomike financiare nuk është e mirë, e dimë që do të ketë probleme edhe në vitin 2026. Pra, për vitin 2024 Drejtoria e Bujqësisë fermerëve ju ka mbetur borxh vetëm për subvencionim të qumështit 278.000€ për vitin 2025 po ashtu 278.000 e po ashtu janë të planifikuar për vitin 2026 278.000 € euro që nëse rrumbullakohet janë afër 1 milion euro konkretisht 834.000 € borxhe të cilat komuna e Vushtrrisë nuk i ka subvencionuar bujqit dhe fermerët të cilët edhe ashtu ballafaqohen çdo ditë me një punë të rëndë. Tek Drejtoria e Arsimit edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, i ka shtruar këto pyetje dhe këtu po kërkoj përgjigje ta di tek faqja 19 tek orët

mësimore të planifikuara, të mbajtura dhe të pa mbajtura është shumë interesant që më shumë ka orë të mbajtura se të planifikuar. Pra ju referohem si rregull zakonisht gabimeve teknike. Po ashtu për neve është shqetësuese që prej shumicës së shkollave të cilat i kemi në komunën tonë, shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta, kemi mungesë të kabineteve, mungesë të laboratorëve, kemi mungesë të bibliotekave. Kjo është goxha shqetësuese. Nëse e shikojmë dhe krahasojmë suksesin tek klasën e nënta sukcesi i arritshmërisë, shihet që nga viti 2024, në vitin 2025 kemi një rënie për 2.92%. Pra, në vitin 2024 kalueshmëria ka qenë 47.79, në vitin 2025 kalueshmëria është 44.87. Në testin e arritshmërisë nga 29 shkolla, 21 shkolla pra në raport në faqen 26, 21 shkolla kanë kalueshmëri të vogël nën 50%. Këto statistika flasin për gjendjen e arsimit në të cilën gjenden shkollat e Vushtrisë. Po ashtu ndoshta ka qenë gabim teknik drejtoreshë, edhe pse ju nuk keni qenë drejtoreshë në këtë fazë, por tri shkolla në bazë të këtij raporti e kanë kalueshmërinë nën 1% që është abnormale, është jo normale sepse nuk mundet nuk mundet me ekzistua kjo. E po ashtu shohim që dy shkolla kanë kalueshmëri mbi 90%. Për çfarë ne jemi të lumtur? Për shkollën “Rexhep Musa” në Ceceli e cila ka kalueshmërinë e ka 95.23 dhe shkollën e mesme të ulët në Pestovë e cila e ka kalueshmërinë 97.31. Mirëpo tek shkolla në Pestovë po ashtu vërehet sigurisht një gabim teknik sepse tek vajzat shihet që kalueshmëria është 113%. Pra nuk ka mundësi bre me kanë 113% sepse se deri 100% ka kalueshmëri. Po jo 113%. Të gjitha këto dhe shumë çështje të tjera, por pasi që nuk është kryetari janë çështje që duhet të diskutohen. Po ashtu në shumë shkolla këto ditë, unë e pashë edhe një reagim mbrëmë të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë me theks të veçantë e theksojnë komunën e Vushtrisë që ka përgatitur disa kontrata për të gjithë mësimdhënësit edhe për ata që kanë kontrata valide, kanë përgatitur kontrata të reja dhe në reagimin e sindikatës thuhet që janë kontrata të kundërligjshme. Kjo pjesë e bënë përgjegjëse drejtoreshën sepse e pashë një kopje të kontratës të cilën ia kanë dërguar dhe ato ishte edhe emri juaj pra qysh është e mundur si komunë si qeveri komunale si Drejtoria e Arsimit të mos e analizoni kontratën dhe t’ju ofroni mësimdhënësve kontrata të jashtëligjshme. Kërkoj që si drejtori si komunë të jeni më të kujdesshëm këto kontrata të tërhiqen ku në veçanti thuhet nga sindikata që Komuna e Vushtrisë është e veçantë është duke ju bërë presion mësimdhënësve për me i nënshkruar kontratat. Pra tërhiqni presionin prej mësimdhënësve, tërhiqni ato kontrata, harmonizoni me ligjet fuqi dhe sigurisht që mësimdhënësit nuk ju ikën kontratave, përgjegjësi që ata i kanë.

4. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/2026;

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit- përgëzoj drejtoreshën për hartimin e informatës profesionale. Por njëkohësisht shprehu shqetësimin për klasat e 10 e 12. Bazuar në rezultatin e analizave të gjysmëvjetorit të parë për vitin shkollor 2025-2026 vërehet një situatë shqetësuese ku rreth 48.52% e nxënësve janë vlerësuar me notë të pamjaftueshëm. Janë notuar me notë të pamjaftueshëm ky tregues dëshmon se një pjesë e konsiderueshme e nxënësve nuk kanë arritur nivelin minimal të kërkuar. Në këtë drejtim kërkohet një angazhim i menjëhershëm dhe i koordinuar nga të gjitha nivelet. Kërkoj nga Drejtoria Komunale e Arsimit të paraqes prioritete strategjike për vitin 2026. Te jep raportin, po kisha pasur dëshirë që me i pa prioritetet e juaja. Të raportoi për veprimet konkrete dhe investimet në shkolla të prezantojnë në mbledhje e ardhshme një plan të qartë të investimeve në prioritetet për vitin 2026. Të siguroj mbështetjen dhe trajnime të vazhdueshëm për mësimdhënësit. Gjithashtu kërkoj që mësimdhënësit të hartojnë dhe zbatojnë program shtesë për nxënësit që nuk kanë arritur nivelin e dëshiruar përmes orëve përforcuese

dhe mbështetjen e vazhdueshme. Orët shtesë për mësimdhënësit të paguhen në mënyrë që të sigurohet një motivim dhe angazhim real për përmirësimin e rezultateve. Njëkohësisht i bëj thirrje kolegëve të Kuvendit që të mbështesim financiarisht sektorin e arsimit duke krijuar kushte më të mira për nxënësit dhe mësimdhënësit. Vetëm përmes veprimeve konkrete dhe mbështetjes financiare, angazhimit të përbashkët mund të përmirësojmë rezultatet dhe sigurojmë cilësimet të lartë në arsim vitet vijuese.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se çështja e arsimit është shumë më delikate se sa një raport i caktuar ku përfshihen shifra, numra, dhe mendoj se nuk jemi askund as si shoqëri, as si shtet as si komunë në krye të detyrës të zhvillimeve që janë duke ndodhur në shoqëri. Jemi dëshmitarë të një zhvillimit të hovshëm të teknologjisë sidomos të EA që po i them tash. Kjo të jep me kuptuar që ne duhet me ndërruar qasje komplet pavarësisht këtyre shifrave që jeni duke i përmendur. Po e përmendi qasjen komplet edhe si shoqëri edhe si shtet edhe si organe komunale ndaj arsimit është një diçka që ne edhe si shkollë edhe si mësuese edhe si krejt domethënë problemet i kemi të gjitha lëmit duke filluar prej kurrikulës duke vazhduar me libra duke vazhduar me mësuesit duke vazhduar me qasjen e prindërve ndaj fëmijëve edhe të mësuesve ndaj fëmijëve. Jemi larg prej këtyre koncepteve! Prandaj vlerësoi se për këto çështje i duhen orë të tëra për ti shpërfaqur të metat dhe problemet që i kemi në arsim. Po nisi prej disa problemeve të cilat janë të evitueshme brenda institucioneve komunale këtu unë kështu pa politikë kisha sugjeruar që të ndërmerren disa hapa të cilët megjithatë ndikojnë në përmirësimin e cilësisë edhe të avancimitin e arsimit këtu në komunën e Vushtrrisë. Andaj në terma tjerë , duhet të nisemi nga hapi i parë është mbyllja e shkollave me numër të vogël të nxënësve e shkollave xhuxhe si quhen ndryshe. Është e paimagjinueshme që një fëmijë të zhvillohet në një klasë me një nxënës ose dy nxënës të kryej socializimin. Nuk ka konkurrencë, nuk ka motiv. Domethënë ato shkolla urgjentisht sa janë në numër duhet të mbyllën. Ato duhet të krijohet infrastrukturë që në vitin e ardhshëm mos me startuar hiç. Duket pak ndoshta e dhimbshme në fillim mirëpo rezultati është krejt tjetër. Kemi shkollë me 11 nxënës dhe 13 mësues. Hapi i dytë është për shembull në shkollën SHMU2 gravitojnë nxënës nga Dobërluka, nga Bukoshi, nga Shtitarica edhe këtyre fshatrave përreth. Sipas mendimit tim kjo duhet me u ndërpre menjëherë duhet të bëhet zonimi i shkollave aty ku nxënësit kanë të drejtë të vendosen për arsye se nëse u ndërtuar një shkollë në një lokalitet të caktuar pse mos me shkuar nxënësi i lokalitetit të caktuar në shkollën e cila është ndërtuar për ta po thjesht një prind thotë jo unë po dua me çuar në shkollë se është shkolla më e fortë atëherë po e mbyllim krejt pra atë shkollë pasi nuk është e mirë. Problemi tjetër është shkolla SHMU2. Kështu ne jemi tash të vetëdijshëm që ë fëmijët nga mosha prej klasës së gjashtë deri në klasën e nëntë janë në atë evolucionin më të madh të zhvillimit të trurit edhe të ndryshimeve që psikike dhe fizike që i pësojnë në atë moshë. E tash grumbullimi i të gjithë atyre nxënësve në të gjitha shkollat në një shkollë të vetme mendoj që është që gabim në start. Që do të thotë është dashur me ndërmarrë hapa që ata nxënës të kthehen në shkollat mëmë. D.m.th. një pjesë të kthehen në shkollën “Mustaf Venhari” pjesa tjetër në këtë shkollë tjetër “Naim Frashri” në mënyrë që të shpërndahen ajo pjesë e nxënësve të cilët janë problematik në kuptimin pozitiv sepse ata natyrën e kanë të tillë në moshën e tillë që kur janë shumë në një vend të caktuar ata bëjnë probleme edhe më shumë. Një tjetër gjë e vërejtja në raport mesatarisht i bie 13 nxënës një mësues. Ne e dimë normën e nxënësve që duhet me pas një mësues që duhet të jetë 18 deri 21. Domethënë ne e kemi tejkaluar jashtëzakonisht. Duhet me pasur kujdes politikat kadrovike që zhvillohen nga DKA për pranimin e mësimdhënësve. Vjen një ditë një ministër edhe thotë prej muajit të ardhshëm ose prej viteve të ardhshëm strikt duhet me pas kaq nxënës një mësues çka bëjmë ne, atyre mësuesëve. Problemi tjetër është zgjidhja e mësuesit të vitit që e keni bërë. Ne kemi mësues që kanë arritur rezultate në

nivel republikan. A janë përfshirë ata mësues në kategorinë e mësueseve që janë shpërblyer, apo i keni shpërblyer sipas meritave ose preferencave partiake të juve? Keni mësues i cili e ka marrë vendin e parë. Nuk ka me rëndësi në çka e ka marrë e ka marrë në sporte. Nëse është një matematikan i mirë dhe më arrin rezultate të mira, 90% është punë e tij, veç 10% është punë e imja. Po, në qoftë se një ekip, një mësues arrin që një grup prej 10 nxënësve ta ngrit në atë nivel që ajo të merr vendin e parë, domethënë këtu 90% është punë e mësuesit e 10% është puna e nxënësve. Sepse me krijuar grup i cili fiton nuk është lehtë një individ është shumë lehtë me e ngrit. Kështu që edhe këtu nuk pajtohem me këtë politikën e zgjedhjes ose përzgjedhjes së mësuesit më të mirë në komunën e Vushtrrisë.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se kjo informatë është sjellë më e detajuar në kuvend pas kërkesave që i kemi bërë në mbledhjen e KPF-së. Meqenëse drejtoresha tash vonë ka ardhur dhe kjo informata është e përfundimit të gjysmëvjetorit të parë desha me u ndalë tek numri i institucioneve publike private para domethënë përpara shkollorëve. Sa i përket dy çerve publiko-private të cilat nuk janë të përfshira tek institucionet para fillore por janë të përfshira tek raporti i zhvillimit të aktiviteteve dhe të arriturave si të arriturat që e keni kategorizuar këtë pjesë dy çerdhet publiko private në Shtitaricë dhe në Stanovc. A ka mundësi me na treguar qysh po funksionojnë? Sa po i përmbushin kërkesat e banorëve aty përreth që me ditë a keni bërë mirë apo nuk keni bërë mirë që këto dy objekte i keni dhënë në shfrytëzim për një organizatë joqeveritare siç është CIPOFI. Pastaj pyeti për shkollën aneksin në “Mustafë Venhari” kur me u lëshuar edhe a keni me pre prapë shiritin lidhur me këtë projekt. Më tej derisa isha këtu duke folur në seancë më herët rreth kërkesës së edukatorëve për pushim për javën e ardhshme të pushimit pranveror. Merr edhe një kërkesë këtu tek raporti janë të përfshira 86 edukatore. A janë të ndara profesionalisht këto edukatore në çerdhet shtetërore? Kur dihet që në kopshtin “Folja 2” janë dy punëtoreshë më pak dhe është mungesë e stafit edukativ në kopshtin “Folja 2” ndërsa në kopshtin Folja 1 dhe 3 ka më shumë edukatore në grupe pothuajse në të gjitha grupet nga 3 edukatore.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- tha se temat rreth arsimit kërkojnë shumë më shumë kohë. Megjithatë ne jemi fokusuar në informatën për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/2026. I kam disa kërkesa për drejtoreshën tash sepse edhe në këtë fazë kjo nuk ka qenë drejtoreshë. Pra në informatë nuk është e përfshirë siguria në shkolla, një çështje shumë e ndejshme dhe po e shohim që secilën herë dëgjojmë edhe nëpër media edhe nëpër portale që ka probleme të sigurisë në shkolla. Prandaj kishte me qenë mirë që të përfshihen informatë dhe të mbahen takime sa më shumë me nxënës të gjitha niveleve për rëndësinë e sigurisë në shkolla. Po ashtu nga informata e kam analizuar dhe kam parë që në informatë nuk është i përfshirë në këtë gjysmëvjetor numri i orëve të planifikuara, të mbajtura dhe të pa mbajtura. Në shumë shkolla kemi humbje të orëve si pasojë e mungesës së mësimitdhënësve në disa lëndë si në gjuhë gjermane, në fizikë, kimi. Kjo është si pasojë e mungesës së mësimitdhënësve, por edhe si pasojë e vonës në rekrutimin e stafit nga ana e Drejtorisë të Arsimit në Komunën e Vushtrrisë. Nga informata shihet se tek nxënësit e klasës 1-5 pesë suksesi i pamjaftueshëm është shumë i vogël. Pra kemi as 1% sukses të pamjaftueshëm. Kurse te klasat 6-9 në faqe 12 suksesi i pamjaftueshëm është 34.03%. Kurse te klasat X-XII, faqe 13 suksesi i pamjaftueshëm është shumë i lartë dhe arrin në 48.52%, pra afër 50% kemi sukses të pamjaftueshëm. Kjo përqindje është e lartë dhe është goxha shqetësuese. Shqetësuese është edhe numri i madh i mungesave të nxënësve në këtë periudhë raportuese. I kemi 120.382 mungesa të arsyeshme e 38.979 mungesa të paarsyeshme që në total mbajnë 159.361 mungesa të nxënësve në orë mësimore. Edhe kjo është shqetësuese, pra numri i madh i mungesave të nxënësve në orë mësimore në periudhën raportuese për të cilën

po flasim ka ende shkolla të cilat nuk kanë ende ujë të pijes, ka ende shkolla pa laboratorë dhe pa kabinete, ka ende shkolla pa fotokopje, pa letër e pa toner. Për më keq, e lexova në një portal që komuna e Vushtrrisë në vend që me ble fotokopjet qysh është traditë e me dërguar shkollave, ka marrë fotokopje me qira. Kjo është shqetësuese. Pra, komuna e Vushtrrisë ka marrë fotokopje me qira për shumicën e shkollave e nuk i ka blerë ato. Kjo është shqetësuese dhe kërkon përgjigje edhe nga Drejtorja e Arsimit, por edhe nga Drejtorja e Prokurimit. Pra pse me marrë me qira me një çmim jashtëzakonisht të lartë. Kurse gjithmonë janë blerë fotokopjet e pastaj edhe tonerë, ngjyra, letra, të gjitha ato. Shumë shkolla kanë pasur po ashtu probleme me ngrohje si pasojë e vonesës në furnizim me lëndë ndjekëse e po ashtu edhe në shumë shkolla njejt sanitare janë të dëmtuara. Në Komitetin për Politikë dhe Financa kam kërkuar një informatë shtesë për shkollën private që është tek shkolla e mjekësisë. E falënderoj drejtoreshën që e kishe sjellë. Po ish informatë shumë e shkurtë. besoj që herëve të tjera të jetë të ofroni informata pak më të detajuara, sepse edhe kjo shkollë, domethënë në këtë shkollë shkojnë fëmijët, tanë dhe është mirë pra me pas një raport të detajuar. Edhe atë që e thashë më herët, çështjen e kontratave të mësimdhënësve, kishte me qenë mirë pra me studiuar mirë edhe me vazhduar tutje. E po ashtu për periudhën raportuese kur po flasim shumë mësimdhënës të cilët e kanë filluar punën ka më tepër se gjashtë muaj ende nuk janë në listën e pagave, nuk marrin paga. Këtu kam një pyetje drejtoreshë. Cila është arsyeja pse mësimdhënësit dhe nuk është numër i vogël nuk po i futni në listën e pagave? Ata janë të detyruar të punojnë deri në një vit pa i futur në listën e pagave, pa marrë pagë kur buxheti është i planifikuar për numrin e caktuar të mësimdhënësve punëtorëve të arsimit në komunën e Vushtrrisë.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-tha se në seancën e fundit ka kërkuar nga Drejtorja e Arsimit të shpallen vendet e punës për drejtor nëpër shkollat e mesme të ulëta dhe mesme të larta. E falënderoj Drejtoreshën që menjëherë ka qenë reagimi i tyre dhe ka shpallur konkurset për drejtorë. Pastaj tek zgjedhja e punëtorëve më të mirë nëpër shkolla s'po them 100% veç 90% janë përzgjedhje politike. E dimë vetë sepse në shkollën time atë e anashkaloj, atë se ka qenë me meritë që është më e mira tek zgjedhja e punëtorëve duhet të zgjedhën punëtorët për secilin nuk cakton ato është i sportit, a është kulturë mësimdhënës i fizikës apo i matematikës. E dini mirë nuk po përmend me emër. Unë e përgëzoj Ramizin që është përzgjedhur sepse është meritë. Por vëllai im është me pesë vende të para në nivel vend të Kosovës. Vendin e parë që është gjithë, që ka marrë vendin e parë dhe nuk është as në shkollë mësimdhënësi më i mirë veç jo dini mirë që vitet e para kur ka ardhur në shkollën SHUM2, ka qenë në vendin e parë me vajza e me djem që asnjëherë nuk e dinë, ndoshta ka marrë pjesë por nuk u rendit as vendin e parë as të dytën as të tretën, kështu që duhet me pas pak konsideratë edhe nga komuna që mos të politizohet edhe shkolla. E katërta desha të kërkoj edhe t'i tregoj edhe njëherë Drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport se më ka shkruar një email ku me ka kthyer përgjigje ku ka sqaruar se që nuk ka asnjë ekip të tërhequr nga gara. E vetmja ekip e klubit të Volejbollit AS Vushtrria në Super ligën e Kosovës e vetmja në nivel të Vushtrrisë është tërhiq nga gara dy lojët e fundit, për arsye që nuk ka pasur mjete financiare me shkuar me luajt me ekipin kundërshtar.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-tha se e pagëzoj drejtoreshën e DKA-së për aspektin struktural të raportit dhe për statistikën e bollshme që i ka futur në raport, megjithatë i mungojnë që të rekomandoj për hera të tjera domethënë pjesa përfundimit çfarë dalin nga drejtorja. Pajtohet me profesorin Refik Maloku edhe të gjithë këto duhet të pajtohem besoj sepse me juve znj. kryesuese jemi një kohë të gjatë këtu dhe kemi parë prej vitit 2006/2007 raportet e policisë kanë dëshmuar që si Vushtrri kemi pasur më shumë banorë, por vazhdimisht në çdo mandat kemi pasur statistika shqetësuese çdo herë më të mëdha edhe në shifra dhe në kategori të problemeve. Dhe për këtë

pastaj lind një pyetje se çka është ajo që po e bie shoqërinë në këtë situatë. Mendoj që raportet e policisë janë një indikator i mjaftueshëm me parë se ka po shkon në rini dhe shoqëria jonë dhe është dashur me kanë shqetësuese dhe me unitet politik të të gjithëve për me gjet indikatorët dhe me i trajtuar rastet. Në faqen shtatë pa dashur me hy në statistika se ka profesionistë të lamis këtu dhe atë pjesë po la atyre dhe mjaft besoj folën. Por në faqen shtatë pika tre por dhe pika e tjera në kontekstin e motivimit a ka diçka që këta nxënës të cilët demonstrojnë aftësi të mira dhe përfaqësim të mirë të arsimit në Vushtrri qytetarëve tonë dhe qytetit tonë a kanë një farë motivime si financim në përfaqësimin tonë në këto gara. Megjithatë për gjithë neve duhet me mbet shqetësuese vlera dhe trajtimi i emrit mësues. Mendoj që secili në familjet tona, në mjediset tona kemi një anëtar ose familjarë ose kolegë që e ka emrin mësues, arsimtar ose profesor dhe trajtimin që sot është duke pasur një rënë anë nga ligjet dhe rregullat strikte dhe në anën tjetër nga trajtimi dhe mosrespektimi i nxënësve. Të dashur kolegë, mendoj që kjo është shqetësimi më e madhe jonë si shoqëri. Këtu dhe në kolegjiun e Asociacionit të Komunave të Kosovës, por edhe takimet eventuale që mundesh me i pas me ministrinë mendoj që vlerës së mësuesit duhet t' jepet rëndësi me një unitet të gjithë drejtorëve të gjitha komunave të Kosovës, qoftë me një deklaratë të përbashkët, qoftë me veprime konkrete. Rregullat për nxënësit duhet të jenë shumë të qarta dhe jo një prind sot fatkeqësisht edhe raporti prind nxënës dhe mësues, qoftë edhe drejtorinë nuk është në nivelin e duhur. Mësuesit tonë sot dhe asnjëherë nuk guxojnë të ndihen të kërcënuar politikisht nga çfarëdo pushteti që është ose që mund të vij në të ardhmen. Ata duhet të trajtohen të fuqishëm në mënyrë që të kemi gjenerata që premtojnë për këtë vend për një ardhme më të mirë.

Naile Bekteshi, drejtoreshë e DKA-së- përshëndetje për të gjithë, e nderuara kryesuese e kuvendit, të nderuar drejtorë të drejtorive, të nderuar anëtarë të kuvendit dhe ju të dashur qytetarë. Kam kënaqësinë që sot jemi këtu së bashku të diskutojmë për të mirat dhe për cilësinë në arsim. Secilin nga ju e falënderoj për angazhimin dhe për sugjerimet dhe për pyetjet që i keni bërë gjatë kësaj seance. Tutje ajo duke u përgjigju në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit shtoj, se çështja e kontratave sa i përket shqetësimit lidhur me harmonizimin të kontratave të punës së mësimdhënësve ne nuk e kërcënojmë asnjë, kurrënjëherë mësimdhënësit. Kontrata e punës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër me legjislacion fuqi. Ju njoftoj se ky është një proces krejtësisht i ligjshëm dhe është i iniciuar nga Departamenti i Menaxhimit të Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Do të thotë kjo kontratë që është dërguar mësimdhënësve përmes drejtorëve është e ligjshme duke u bazuar në DMZP ku modeli i kontratave të reja është përshtatur me zyrtarët publik, mësimdhënësit dhe stafin tjetër profesional teknik në shkolla. Është në pajtueshmëri të plotë me Ligjin numër 08 L/197 për Zyrtarët Publik dhe aktet nënligjore përkatëse Ligjit të Punës dhe aktet nënligjore përkatëse, Ligjit për Arsimin në Komuna dhe Ligji për Pagat në Sektorin Publik asgjë nuk është e jashtëligjshme. Sa i përket pyetjes zonjës Gresa sa i përket përqindjes që është e shqetësuar si Drejtori e Arsimit i zbatojmë udhëzimet për vlerësimin e nxënësve duke u bazuar në udhëzimet 06/2022 nxënësit informohen vazhdimisht për orientim në karrierë. Sa i përket pyetjes që ke shqetësimi për klasat e X, ju kisha falënderuar secilit, profesorin Refik Maloku. Faleminderit shumë për sugjerimet e dhëna. duke u bazuar në atë që deklaroi që të bëhet fuzionimi i shkollave. Ne si Drejtori e Arsimit, do të kemi parasysh këtë çështje, sepse dhe për neve është shqetësim. Po ashtu dhe për atë që të bëhet zonimi i shkollave si për shembull si ceku shkollat vendet Dobërllukë, Smrekonica apo Sllatina të shkojnë në shkollat përkatëse që ju përket zonimi atyre e jo të vijojnë shkollën “Mustafë Venhari”. Problemi i mësimdhënësve, përzgjidhja e mësimdhënësve ju njoftoj se nuk është aspak politik. Përzgjedhja e mësimdhënësit më të mirë është bërë duke u bazuar në raportet e dërguara nga

drejtoritë e shkollave përzgjedhja e mësimdhënësve nëpër institucionet përkatëse. Pastaj u bë dërgimi në DKA e DKA-ja ka bërë përzgjedhjen e mësimdhënësit më të mirë. Aspak nuk ka qenë politik. Sa i përket pushimeve të institucioneve parashkollore zakonisht institucionet, parashkollore në bashkëpunim me dy koha, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ, pushimet vjetor mundet me pas nga 1 korriku deri më 15 gusht, varësisht si organizojnë institucionet parashkollore në bashkëpunim me DK-në, sepse ashtu e thotë udhëzimi administrativ sikurse se policia, shëndetësia, as institucionet parashkollore nuk kanë pushime pranverore. Vetëm festat zyrtare mund të zbatohen. Sa i përket stafit edukativ, nuk ka informacione që në institucionin parashkollor, Folja 2, ka mungesë të stafit edukativ si Drejtoreshë e Arsimit. Sa i përket pyetjes së z. Ymer Haradinaj, për orët e mbajtura, të planifikuara, të mbajtura dhe të përmbajtura, ato dorëzohen vetëm në raportin vjetor, jo në raportin informim për gjysmvetorin e parë ose të dytë. Fotokopja me qira është marrë që nga viti i kaluar duke pasur parasysh furnizimin më të lehtë dhe më të shpejtë sepse duke u bazuar që kryhet fotokopja toneri dhe për servisimi i fotokopjeve duke pasur parasysh e kanë marrë këtë fotokopjen me qira. Meqenëse tash shkollat i kemi pak në gjendje jo të mirë, shumica prej tyre nuk janë me fotokopje sepse ka skaduar kontrata për furnizim me fotokopje me qira. Njoftoj se tash procedura është iniciuar për furnizim me aparate fotokopjues. Sa i përket raportit për siguri në shkolla, Drejtoria e Arsimit ka zhvilluar bashkëpunim të vazhdueshëm dhe korrekt me policinë në komunitet. Gjatë gjysmvetorit të parë të vitit shkollor 2025-2026, situata e sigurisë ka qenë e qëndrueshme dhe pa incidente të theksuara që do të kërkonin trajtim të veçantë. Ligjëratat nga Policia e Kosovës kanë qenë tre herë me temat: rregullat në komunikacion, interneti dhe rreziqet për fëmijët, kujdesi nga mjetet piroteknike. Po ashtu dhe për shkollën e mjekësisë siç u cekë e kemi marrë informacion aq sa na ka dorëzuar shkolla e mjekësisë si shkollë private. Kemi marrë informatë shtesë. Ke thënë se shkolla kemi numëruar 38 shkolla. Po jo sipas numërimit tuaj janë 39 shkolla. Realisht janë 38 shkolla sepse shkolla e Mesme e Muzikës Tefta Tashko është paralele e ndarë e Mitrovicës. Pajtohet se vlerësimi i mësuesit duhet të jetë primar dhe kurrsesi asnjë mësimdhënës mos të ndjehet i kërcënuar apo jo në gjendje të mirë në vendin e punës. Në fund i falënderoj të gjithë anëtarët e kuvendit duke u zotuar për një bashkëpunim të mirëfilltë, komunikim të hapur dhe respekt të ndërsjellë. Vetëm të bashkuar mund të më të rrisnin cilësinë në arsim.

5. Raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm;

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit pyeti se përse pse nuk e kemi as kryetarin e as nënkryetarin edhe një pjese të madhe të drejtorëve këto sot prezent kur po flasim për një raport i cili është i rëndësishëm për komunën edhe për vetë institucionin. E nderuar kryesuese, të nderuar kolegë asamblast , qytetarë të Vushtrrisë, këtu sot po e demaskojmë një sistem që nuk punon për qytetarë, por po përfituesit e privilegjuar. Rrjedhimisht ky raport i auditorit që e kemi para nesh nuk është thjesht një përmbledhje e shifrave, është një certifikatë e dështimit ndaj moralit dhe administratës. Është një pasqyrë e një qeverisje që interesin publik e ka zëvendësuar me interes klanor. Në Vushtrrinë tonë po instalohet një model i rrezikshëm i drejtësisë selektive. Përderisa qytetarit të thjeshtë Vushtrrias i bllokohet gjrrollogarit dhe troket përmbaruesi për një faturë për mbeturina, ky ekzekutiv ka zgjedhur të bëjë gjuhë mbi borçet skandaloze të atyre që i konsiderojnë të paprekshëm. Si ka mundësi që një lokal afarist në zemër të qytetit shfrytëzohet për shtatë vite me radhë pa paguar asnjë cent qira? Borxhi ka arritur shifrën marramendëse prej 30.000 € dhe çfarë keni bërë ju? Asnjë hap ligjor, asnjë

ndërprerje kontrate, asnjë masë. Kjo nuk është pakujdesi, është favorizim i pasur klanor që e grenë buxhetin tonë të përbashkët. Pronat në Gracë dhe Balincë. Po flasim për raportin i cili është ofruar dhe ato janë të gjetura. E njëjta historia është edhe me toka bujqësore. Ato janë kthyer në bashqe private ku qiramarrësit e pandërgjegjshëm nuk paguajnë. E ju nuk guxoni t'i prekni komoditetin e tyre! Duke inspektuar vetëm 9.5% e pronave ku me ligj ju thuhet që është obligim 20% i tyre të inspektohet. Ju keni bërë sabotim të qëllimshëm e këto mjete që do të duhej të shkonin për çerdhe shkolla e mjekësi. Nëse ndalemi tek pjesa e tenderëve nuk ka gjë më të ulët se sa manipulimi i tenderëve në kurriz të shëndetit të qytetarëve. Tek raporti i auditorit thuhet qartë se furnizimi dhe montimi i kallbës në ÇKMF me vlerën 62.000 € ju keni guxuar të vendosni emrin e prodhuesit me kod direkt me dosje. Ky është një krim administrativ. Pse desh të përcaktohet marka? Sepse fituesi duhet ditur se si të fillojë gara dhe si ta fitojë atë. Ju keni vrarë konkurrencën e lirë dhe keni shkelur mbi të dy këmbët Ligjin e Prokurimit Publik. Normalisht ky tender është një qepje me porosi ku në cilësi të tjera e të saj po e blini besnikërinë e bizneseve të afërta me ju. Është për keqardhje që kryetarin e komunës së Vushtrrisë nuk e kemi këtu as nënkryetarin që t'ju përgjigjet pyetjeve që unë i kam sot për të. Të nderuar kolegë, ky model ka dështuar sepse nuk e sheh paranë publike si djersë të popullit, por si një rehatit politike. Prandaj sot kërkoj përgjigje të menjëhershme. Kush janë shfrytëzuesit e këtyre lokaleve dhe pronave që nuk paguajnë qira? Kërkoj që emrat e tyre të bëhen publike këtu në këtë seancë. Çfarë fshihet mbrapa tyre dhe çfarë e lidh kryetarin me këta njerëz që i amnistion? Me çfarë fytyre e lejoni që një biznes të na ketë borxh 30.000€ për shtatë vite, ndërsa qytetarët e thjeshtë i dërgohet përmbaruesi për një borxh më të vogël. Cili është ai interes madhor që ju shtyn të vendosni emra markash në tenderët e shëndetësisë duke e kthyer Qendrën e Mjekësisë Familjare në një pazar të interesave tuaja privat. Andaj të nderuar zotërinj llogaridhënia nuk është opsionale. Qytetarët e Vushtrrisë presin emra dhe përgjegjësi jo arsyetime boshe.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në deklarin e saj para kuvendit tha: sa i përket Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit, mundemi me thënë lirshëm se kjo çfarë na keni sjellë për seancë është një fontanë dëshirash dhe nuk ka të bëjë fare me realitetin. Nga 15 rekomandimet e auditorit keni deklaruar se i keni zbatuar tetë pjesërisht të zbatuara gjashtë dhe të pazbatuara vetëm një, gjë që nuk është ashtu dhe mund t'i referoheni materialet ku rekomandimi pesë çështja B5 tek kjo, çështja B5 vonesë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve keni deklaruar se është zbatuar por ky rekomandim është dhënë për vitin 2024 gjë që i bie rrjedhimisht është zbatuar në vitin 2025 dhe vetë kryetari ka deklaruar se në vitin 2025 komunës i janë marrë mjete mbi 4 milion euro që domethënë shumë fatura kanë mbet papaguar ose janë paguar me vonesë pas 30 ditëve siç është transporti i nxënësve gjashtë muaj pas BIK-u ose pagesa për Speak. Ndërsa rekomandimi tjetër është rekomandimi tetë çështja C1. Në sektorin e tatimit në pronë kurrë nuk ka pasur më shumë punëtorë sepse vetëm në mandatin e kryetarit Ferit Idrizi janë pranuar katër pesë punëtorë në këtë sektor dhe nuk kanë arritur që ta plotësojnë këtë kriterin e 20%. Andaj ajo çfarë kanë bërë e kanë ofruar një tender për një firmë private kur rrjedhimisht ka pasur punëtorë të mjaftueshëm për ta kryer këtë punë dhe ta arrijnë këtë kriter.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- përshëndetje kryesuese të nderuar anëtarë të kuvendit. Meqenëse në aspektin ligjor, Drejtoria për Buxhet dhe Financa është e obliguar që raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare ta bëj dy herë në vit. Formën dhe rekomandimet e dhëna për implementimin e tyre. Mirëpo ne vitin e kaluar kjo është një informatë për juve sepse kjo as nuk votohet as nuk përmirësohet këtu vetëm si informohet që jemi të obliguar me ligj të informojmë kuvendit që ku kemi mbërri me hapat e veprimit. Sa i përket realizimit dhe të arriturave të tyre tash e kemi

auditmet për vitin 2025 dhe auditori do ta thotë fjalën përfundimtare. Nga 15 rekomandime, një është i pazbatueshëm, tetë janë të zbatuar pjesërisht të zbatuar janë gjashtë. Tutje shtoj se asnjë auditim çdoherë që bëhet nga Zyra Kombëtare e Auditimit nuk mundet me qenë perfekt. Gjithë ka zbrazëtira për rekomandime dhe ato rekomandime të cilat i japin ata secila organizatë buxhetore është e obliguar t'i zbatojë dhe t'i analizojë në tërësi. Sa i përket këtij raporti ne mund të diskutojmë shumë mirëpo ky nuk ndryshohet. Kjo është informatë për juve. Arsyeja pse jemi të obliguar dy herë në vit këto implementime, dhe rekomandime t'i prezantojmë edhe tek ju. Ata e do ta japin fjalën përfundimtare. Sa i përket çështjes, që u tha çështja 5 është shumë e vërtetë se të gjitha obligimet e papaguara ne jemi të obliguar se organizatë buxhetore t'i evidentojmë. Nëse ka mjete buxhetore ato implementohen për pagesë nëse s'ka mbesin si obligime të papaguara. Dhe me çfarë sfidash jemi ballafaquar ne me vendimet gjyqësore, ajo nuk është faj i institucionit tonë. Pasi me këto problematika të gjitha komunat janë duke u ballafaquar. Bile është fat i mirë që komuna jonë është në përfundim e sipër të kryerjes së këtyre obligimeve. Mirëpo mbetem shumë optimist që këto mjete buxhetore që ju kanë marrë organizatës sonë do ju kthehen nga niveli qendror apo nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Arsyeja pse është një handikep edhe është një kolaps për të gjitha komunat. Ne e patëm edhe raportin më herët të subvencioneve. Nuk është që drejtorët ose komuna nuk ka ditur të planifikojë. Planifikimi ka qenë adekuat, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore ka dështuar plani edhe ato mjete barten për vitet fiskale. Kështu që ne si drejtori jemi të obliguar ta informojmë kuvendin. Kuvendin e kemi informuar lidhur me zbatimin e këtij plani të rekomandimeve.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se sa i përket pikës të pestë të rendit të ditës në lidhje me rekomandimet e auditorit për vitin 2025, planet e veprimit e zbatimit të rekomandimeve po e shoh këtu që disa rekomandime janë për kontrata për qira. Këto kontrata janë bërë në vitin 2016-2017, pra për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale. Këta nëntë pronarë që janë cekur nga auditori aty nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj komunës së Vushtrrisë. Borxh total nga këta nëntë operatorë të cilët kanë marrë është shumë i madh. Nuk kemi informata të detajuar nga kush shfrytëzohen këto prona komunale. Borxhi total ndaj komunës është 42.611€. Ndoshta kishte me qenë mirë që komuna e Vushtrrisë me dalë dhe me u bë pak presion me marrë qiranë për shkak se edhe ashtu jemi në kolaps si komunë me buxhetin. Ndoshta pak diku një projekt që mund me mbyllë me 42.611€ të këtyre qirave. Vetëm njëri nga këta pronarë që ka marrë pronë komunale i ka 30.000€ borxh ndaj komunës së Vushtrrisë. A ka mundësi me ditur kryesuese meqenëse se s'ka kush jep përgjigje sepse nuk është prezent shumica e ekzekutivit këtu? A ka mundësi me na treguar këto kontratat që kanë kaluar afatin? Domethënë janë dhënë për shtatë vite dhe e kanë kaluar afatin. A janë kthyer pronat në pronësinë e komunës aktualisht? A i keni larguar këta pronarë nga këto prona edhe këto të tjerat prona që kanë mbetur po mendoj lokalet që kanë mbetur ende në qiramarrje, a keni me i obliguar me e kthyer borxhin ndaj komunës?

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit ceku se sot e kemi në rend dite Raportin lidhur me Progresin në Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe Planin e Veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve. I kemi 15 çështje që i kanë ngritur Zyra Kombëtare Auditimit që për neve këto janë shqetësuese. Ndërsa i kemi edhe rekomandimet dhe veprimet e planifikuara për të ndërmarrë konkretisht nga kryetari i komunës që për neve pak a shumë janë qesharake këto rekomandime. Do të tentojmë që t'i listojmë në dy tre pika të shkurtra që mos me ju marrë kohë edhe juve. Te çështja A2 ose te pika e gjashtë, te ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve, vërejtja kryesore është se pagesa e projekteve kapitale në vlerë prej 68.756 € janë ndërmarrë nga fondet e projekteve të tjera të aprovuara me Ligjin e Buxhetit. Në këtë çështje është cekë direkt që me vendim të kryetarit është bërë një pagesë e tillë që e

kemi shkelë ligjin në këtë rast. Kemi çështjen tjetër te pika B6, te borxhet që i diskutuan edhe kolegët tjerë pa u ndal në detaje. Shuma e borxheve ishte mbi 42.000 000 €, gjatë viteve 2017-2021 kemi pasur procedura të njëjta kryesuese sikurse atëherë edhe tash kemi një menaxher të kontratës që do t'i mbikëqyrë këto kontrata ose këto pagesa të këtyre qirave të qiramarrësve. Pagesa prej 42.000 € është pagesë goxha e lartë. Mjafton që menaxher i kësaj kontrate të i rrijë gati kësaj pune t'ju shkruajë vazhdimisht edhe pastaj do të kemi edhe shlyerje të këtyre borxheve. Tutje do të ishte mirë të ishte prezentë edhe Drejtori i Urbanizmit të çështja B10 pika 13 tek vonesa në realizim të projekteve kapitale kemi disa projekte janë pesë ose gjashtë projekte që kemi vonesa të theksueshme. Prej tyre, ndërtimi i rrugës “Bekim Berisha –Abeja”, ndërtimi i rrugës “Lumni Surdulli” dhe ndërtimi i rrugës “Avni Saraçi” në vlera goxha të mëdha, ku vetëm njëra prej tyre 778.000 €, 685.000 € tjetra 250.000€ janë projekte që është dashur me përfunduar në dhjetor të vitit 2024 kanë qenë projekte dyvjeçare, kurse tani jemi në vitin 2026. Buxheti i Drejtorisë të Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për këto projekte është shpenzuar 100% ndërsa jemi dëshmitarë të gjithë çfarë gjendje kemi rrugën “Bekim Berisha-Abeja” në Begaj. Njëjtë e kemi gjendjen afërsisht edhe të këtyre dy ose tre rrugëve do të thotë këtu i kemi problemet sepse pagesa është përfunduar 100% ndërsa gjendjen faktike në terren e kemi larg shumë larg realitetit ose projektit që është ekzekutuar. E lexova edhe rekomandimin e kryetarit të komunës që do t'i kemi parasysh që për projekte të tjera do t'i hartojmë projektet. Fillimisht ne i dimë problemet që kanë ndodhur në këto tri segmente rrugore. Në një projekt me vlerë 785.000 € me u punuar pa projekt zbatues, kjo nuk ish dashur në asnjë formë me ndodhë. Kryetari i komunës na thotë që do t'i kemi parasysh që për projekte të tjera të hartohet projekti i zbatuar. Komuna e Vushtrrisë e ka një kontratë për hartimin e projekteve që vlera është mbi 800.000 euro. Prandaj të paguhen nga komuna vlera e mjeteve prej 800.000 € për hartim të projekteve dhe të kemi gabime të tilla ose të harrojmë pozicione këtu, kjo në faktikisht nuk ish dashur me ndodhë assesi në komunën tonë. Sa i përket faqes së fundit, numër 18, kryetari i komunës është zotuar për adresimin e këtyre rekomandimeve, ku njëra ndër pikat thotë që deri në fund të muajit janar 2026 do të diskutojë me kuvendin e komunës. Pjesa tjetër vazhdon. Jemi në fund të marsit 2026. Do të thotë kemi informata jo të saktë këta kemi mos përputhje të gjërave komplet njëra me tjetrën. Kështu që unë e mendoj që kjo është arsyeja pse raporti i auditorit edhe më herët ka ardhur si i kualifikuar dhe në të njëjtë kohë mendoj që do ta kemi një situatë të tillë edhe këtë vit.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se me bëri përshtypje një fjali e Drejtorit të Financave kur tha nuk ka kurrëgjë perfektë. Domethënë këto raporte normal që vijnë edhe me vërejtje është shumë e kuptueshme, mirëpo unë e di edhe një gjë, dallimi mes fjalisë nuk ka kurrëgjë perfektë edhe ka raport të kualifikuar është një gjë diametralisht e kundërt. Çdo raport që kemi marrë që sa vjet, 3 vjet më radhë, e kemi gjithë të kualifikuar. Domethënë nuk është rendi për i perfeksionit, por gjendja është shqetësuese, sepse Komunës së Vushtrrisë, vazhdimisht po i del raporti i kualifikuar, kështu që mos u fshihni mbas këtyre deklaratave të rrejshme.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- sqaroi se anëtarët e kuvendit duhet ta dini që raportet e auditimit bëhen në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Ekonomistët e di më së miri. Sa i përket raportit të auditimit të nderuar anëtarët të kuvendit, pse është i kualifikuar, në cilëndo organizatë buxhetore që e merre për bazë. Vendimet gjyqësore e diskualifikojnë raportin, gjersa kemi vendime gjyqësore përmbarimore të gjitha të tjerat që i ke në rregull prapëseprapë bëhen keq klasifikime financiare dhe kjo bie ndesh me standardet ndërkombëtar të auditimit. Kështu që me rëndësi është që të gjeturat e auditorit gjeneral askund nuk has ndonjë e gjetur se ka korrupsion, por, ka vërejtje të cilat i sugjeron organizatës buxhetore që vitet e ardhshme të mos përsëriten më. Ne në bashkëpunim me të gjitha dikasteret se vetëm

Drejtoria e Financave nuk mund i kryej të gjitha. Po në bashkëpunim me drejtorinë e marrim për bazë të gjitha rekomandimet që na kanë dhënë në mënyrë që çdo vit që vijnë sugjerimet e tyre, rekomandimet e tyre mos përsëriten më. Kështu që ne në bashkëpunim, kuptohet edhe me auditor edhe me drejtorinë komunale dhe kryetarin e komunës edhe me juve si kuvend do të bëjmë maksimumin që në të ardhmen rekomandimet të zvogëlohen apo të minimizohen.

6. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria e Administratës, për vitin 2025;

Fatmire Celcelia, anëtare e kuvendit- tha se e kam lexuar informatën e Drejtorisë së Administratës të tërën. E përgëzoj Drejtoreshën e Administratës edhe komplet punëtorët e administratës që e bënë një punë të shkëlqyeshme. Po e kam një kërkesë konkrete për drejtoreshën e administratës. Kisha kërkuar me nxjerrë një listë të gjithë banorëve të komunës së Vushtrrisë, me dërguar në fotokopjen “Migros” me nxjerrë një mirënjohje për të gjithë banorët e komunës së Vushtrrisë dhe me ja dhënë kryetarit të komunës me nda këto mirënjohje për krejt banorët e Vushtrrisë. Kjo që mos me ju mbetet hatri, se mbaruat dikujt duke i dhënë mirënjohje dikujt jo. Kjo edhe për faktin se në çdo takim, çdo organizim, Kryetari i Komunës ndan mirënjohje, kështu që për të mos i mbetur asnjë militant pa i ndarë një mirënjohje e përfundon këtë çështje përnjëherë duke ju ndarë dekorata dhe mirënjohje secilit banor qytetar të Komunës së Vushtrrisë.

7. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete;

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-sqaroi se materialin e keni marrë me kohë. I kemi dy pika brenda këtij vendimi të cilat duhet të t'i ndryshojmë sipas vlerësimeve të MAPL-së. Pra pika 1.2 ndryshohet në vend të z.Mentor Hasanit vjen z.Stefan Markovi, si dhe pika 1.8 vetë komuniteti ka bërë nënshkrimet dhe ka kërkuar që të ndërrohet z.Adem Hoti me Bekim Çunin, gjë që kjo është e drejtë e komuniteteve dhe ne nuk mund të ndërhyjmë. Sa i përket pikës 1.2, asnjëherë nuk ka ndodhur asnjëherë me na e kthyer vendimin për shkak për të mos përfshirjes së komunitetit që është në kuvend, për shkak se këtë pjesë e kemi përmbushur me komunitetin jashtë kuvendit. Megjithatë ne i përmbahemi atyre ë këshillave dhe sugjerimeve që na jep MAPL-ja.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 16 vota “për” 10 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit me Nr.5100/26 i datës 29.01.2026 lidhur me themelimin e Komiteti për Komunitete, si në vijim:

1.1. Ndryshohet pika 1.2. e vendimit Nr.5100/26, ku në vend të z. Mentor Hasani, anëtarë i kuvendit nga radhët e subjektit politik (PDK), emërohet z. Stefan Markovic nga subjekti politik Lista Serbe, si dhe pika 1.8 në vend të z. Adem Hoti, nga komuniteti ashkali, emërohet z. Bekim Çuni, nga i njëjti komunitet.

2. Pjesët tjera të vendimit bazë Nr.5100/26 i datës 29.01.2026 lidhur me themelimin e Komiteti për Komunitete, mbesin të pandryshuara.

3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, lidhur publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026;

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit- të nderuar të pranishëm, të dashur qytetarë të Vushtrrisë, sot pra nesh kemi një vendim i cili është kthyer për të tretën herë në kuvend dhe është me të vërtetë për keqardhje dhe kjo tregon paaftësinë e kësaj qeverie. Kjo do të kishte qenë më e kuptueshme për një qeveri në fillim të mandatit, por është e pafalshme për një kryetar në vitin e pestë të qeverisjes, e aq më tepër që Zyra Ligjore është me katër zyrtarë, ose nuk po i konsulton kryetari fare ose problemi është diku tjetër. Të gjithë e dimë se kjo listë e pronave për dhënien në shfrytëzim duhet të votohet në dhjetor të çdo fund viti, në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe i planifikuar. Pse sillet tani? Pse po vazhdohet ky avazi i improvizimit të minutës së fundit? Nuk mund të mos dyshojmë që kjo listë e gjatë është sjellë në mënyrë të parregullt edhe me nxitim shërben për të kamufluar interesa specifike për prona të caktuara. Kur procedura nuk është në rregull as qëllimi nuk mund të jetë i pastër. Qytetarët e Vushtrrisë nuk e kanë merituar që edhe pas pesë viteve të qeverisjes së kryetarit Ferit Idrizi, komuna jonë të trajtohet si një laborator eksperimental ku vendimet kthehen prapa si të paligjshme nga niveli qendror dhe kjo nuk është as mungesë e dijes, por është një neglizhencë ndaj ligjit si dhe ndaj interesit publik.

Fatmire Celcelia, anëtare e kuvendit-tha se propozim-vendimi për listën e pronave komunale për dhënien në shfrytëzim është dashur me kaluar në janar të këtij viti. Dhe tani është hera e dytë që MAPL-ja na e kthen këtë vendim propozim vendim për shkak të shkeljeve këtu në kuvend. Në këtë listë janë përfshirë ato pak prona komunale, pavarësisht se kërkohet që kjo listë të publikohen për tu ditur se cilat prona do të jepen në shfrytëzim. Ne si grup kuvendar jemi kundër dhënës së pronave me interes publik që dihet se komuna jonë ka mungesë të hapësirave publike, parqeve, lodrave për fëmijë e që tashmë komuna duhet të mendojë dhe për pronën që ka me vendos stacionin e autobusëve pas që i kemi në buxhet e kështu me radhë. Pra ne si grup jemi kundër dhënies në shfrytëzim sidomos kur dihet që këto prona tash publikohen dhe prej tash dihet fituesi i këtyre pronave. Kryesuese ju duhet të mendoni për të ardhmen e fëmijëve tonë, për të ardhmen tonë sepse është shumë me rëndësi që në të ardhmen ka me ju dënuar historia që të gjitha pronat komunale po i mbanin tek personat e partisë tuaj dhe personat me interes të veçantë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 14 vota “për” 12 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

2. Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.

3. Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrrisë në të ardhmen planifikon

të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

6. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Propozim-vendim për emërimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Vushtrrisë;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pasi i falënderoj gjithë të pranishmit deklaroi: sa i përket propozimit për aprovimin e kandidatëve për komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve konsideroj që është një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme sepse do të jetë shumë e rëndësishme se kush do të udhëheqë me 14 institucione të komunës Vushtrrisë për katër vitet e ardhshme. Prandaj kërkojmë që procesi i zgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukative arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës dhe në komunën e Vushtrrisë të bëhet në pajtim me ligjet në fuqi për arsimin parauniversitar edhe procedurat e përcaktuara me udhëzim administrativ dhe të bazohet në parimet si në vijim: pra, parimi i ligjshmërisë dhe depolitizimit, parimi i meritës dhe kompetencës profesionale, parimi i transparencës dhe bashkëpunimit institucional, parimi i paanshmërisë, mundësive të barabarta dhe mos diskriminimit dhe parimi i barazisë gjinore. Nëse shohim nga 14 institucione të cilat do të në të cilat do të zgjedhën drejtorët dhe zëvendës drejtorët, shohim që këtu kemi një shkollë fillore, 11 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe dy shkolla të mesme të larta. Pra gjithsejtë janë 14 institucione që janë shumë të rëndësishme dhe këtu kisha dashur që edhe Drejtoria e Arsimit, qeveria komunale në përgjithësi anëtarët e komisionit të jenë shumë të vëmendshëm dhe mos na përsëritet vitit 2022 kur ishte bërë përzgjedhja e drejtorëve në pesë shkolla në atë kohë. Pastaj Drejtoresha e Arsimit kishte marrë vendim për anulimin e atij konkursi, ishte dërguar në gjykatë, ishte kthyer. Në fund kryetari i komunës kishte marrë vendim për këtë emërtim. Pra është një proces kompleks prej të cilit nuk kemi përvoja të mira sepse me çdo kusht dhe nga ajo që kemi parë i keni shkelur parimet që i lexova më lart. Pra nuk e keni respektuar parimin e depolitizimit dhe në shumicën e rasteve drejtorët i keni zgjedhur drejtor politik. Bile bile keni marrë edhe drejtor nga asambleja komunale nga Partia Demokratike dhe e keni emëruar drejtori të Gjimnazit “Eqrem Çabej” duke shkelur në mënyrë flagrante parimet e cituara si më lartë siç është ai mos politizimit të procesit të zgjedhjes së drejtorëve zëvendës drejtorëve në institucionet edukative arsimore.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-pak më herët mundova pak me thënë që kjo çështje është shumë më serioze si që mendojmë ne. Mirëpo ne jemi mësuar kështu veç me i kryer punë shpejt e shpejt. Nuk kemi durim me qëndruar as tre orë në një mbledhje të kuvendit edhe pse ajo është njëherë në muaj. Po sidoqoftë kështu për qëndruar në temë. Për shembull shkolla fillore e mesme ulët “Adem Voca” në Pasomë. Pyeti drejtoreshën sa nxënës i ke në Pasomë që po do me zgjidh drejtor. Tjetër

shkolla fillore e mesme ulët “Azem Bejta” në Duboc. Sa nxënës i ke në Duboc që po do me zgjidhur drejtor? Jeni të bindur që aty as njëzetë nxënës nuk janë as njërin as në tjetrën. Pra me fjalë tjera jemi ka investojmë për një çështje kot fare, sepse ato shkolla janë praktikisht buzë mbylljes, ndërsa ne po zgjedhim drejtor për ato shkolla. Prandaj është e nevojshme dhe imediate që të bëhet reforma në çështje e shkollave dhe të arsimit. Tutej duke dashur ti heqim të gjitha dilemat lokale partiake krejt dhe të mendojmë për të mirën e atyre fëmijëve sinqerisht po them një klasë me dy tre nxënës nuk ka kuptim e lëre më ndonjë cilësi në mësim. Prandaj do të thotë ideja ose qëllimi i tij është që mos me pas kësi lloj shkollash fare, dhe që të pezullohet zgjedhja e drejtorëve të bëjmë një ushtrues detyre në ato shkolla ku janë shkolla gjuxhe që po i quajmë derisa të vendosim a po i mbyllim apo nuk i po mbyllim.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se pajtohet me parafolësin e tij sa i përket me zonimit të shkollave. Pajtohet plotësisht që nuk ka logjikë që një shkollë në qytet me i pas 30 nxënës, 35 nxënës, një mësuese që është për mua aty nuk do të ketë proces mësimor. Tutje shtoj se është e vërtetë plotësisht që fshatin Dobërluk janë 15 nxënës në një klasë, ndërsa në shkollën” Mustafë Venhari” janë 35 nxënës, kjo është e palogjikshme e kjo pajtohet plotësisht që duhet me bë zonimi. Unë mendoj që asnjë shkollë e re nuk ka nevojë me u ndërtua, po shkollat ekzistuese duhet me u rinovuar dhe rregulluar qysh duhet, dhe mos me u mbyll. Ndërsa për nxënëset tjerë që mbeten duhet të sigurohet transporti prej fshatit në qytet.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 13 vota “për” 12 vota “kundër”, 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta në Komunën e Vushtrrisë, sipas konkursit **Nr.10425/26 të datës 12.03.2026**, me këtë përbërje:

1.1. Arianit Jashari, Kryesues i komisionit i cili përfaqëson DKA-në;

1.2. Astrit Izroku, anëtar (Drejtor në IEAA-AP);

1.3. _____, përfaqësues i MASHT-it.

2. Komisioni do t’i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Rregullores (QRK) Nr.19/2024, për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zv. drejtorëve, mësimdhënësve bashkëpunëtorëve profesional, asistenteve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo –arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar.

3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat ad hoc.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartcekur.

5. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Pyetje dhe përgjigje.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit-Këtë herë nuk po dua me fol si anëtar i kuvendit, po flas si një qytetar. Sigurisht secili e keni parë një publikim të një libri që ka ndodhur fatkeqësisht i financuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Prandaj si i tillë shtrembërimi i historisë dhe mos verifikimi i të dhënave të sakta ku unë si një i mbijetuar i masakrës së studime dhe mos përmendja e masakrës 22 majit në Vushtri masakra në familjen Gerxhaliu dhe shumë familje të tjera në Vushtri është e papranueshme dhe fyese. Mendoj që kuvendi i komunës dhe komuna e Vushtrrisë duhet të dalë me një reagim dhe tjetra që duhet me bë ne si kuvend me bë një si kërkesë çdo financimi, çdo libri që bëhet tash e tutje, praktikant që kanë të bëjë me historinë e lavdishme të Republikës së Kosovës duhet të jetë shumë i kujdesshëm në financimin e tyre që me dije apo pa dije bëjnë shtrembërimin e historisë. Dhe e kam edhe një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Kam një informatë që në vitin 2025 është blerë një kerr 50.000 €. Nuk e di a është e vërtetë, a bëhet fjalë për një kerr a janë blerë shumë kerre. Nëse është një kerr me na i treguar performancat se për çfarë lloj kerri bëhet fjalë.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-sidomos për pjesën e parë edhe po mendoj që me atë publikim është shtrembëruar historia jonë edhe është prekur ajo që është më e keqja dhimbja jonë e përjetshme që ka me na mbet. Kështu që po besoj që ne të gjithë jemi kundër kësaj dhe mund po e marr të drejtën, po them që në emër të kuvendit me shpreh indinjatën për këtë çështje që është bërë. Sa i përket botimit të librave vazhdimisht kam thënë jo veç për libra historik, por për të gjithë librat që është janë ka bëhen botime enorme pa kurrfarë rregulle që mua personalisht si gjuhëtare më pengon shumë sigurisht edhe të tjerët, por megjithatë është mirë me qenë me u kujdes më shumë për botimet e librave. Nëse ju pajtoheni unë mund në emër të kuvendit me e bërë një deklaratë me e publikuar nëse jeni të gjithë dakord.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- tha se meqë jemi edhe në pikën e fundit të rendit të ditës. Unë gjatë ditës së djeshme kam marrë pyetje nga qytetarët lidhur me problematikat dhe çështjet që ata i preokupoj. Kam pyetje të ndryshme, po më shumë përfshihen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Uroj që drejtori të ketë hapësirë dhe mundësi me na u përgjigj, jo mua por qytetarëve. Pyetja e parë që më është drejtuar në rrjetin tim social. Tek rruga prej vendit e deri në pjesën ku hyrja në qytet tek rruga magjistrale ose të themi rruga kryesore, se çfarë është duke bërë komuna që të rregullojë atë rrugë dhe a është duke u kontraktuar ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës. Kjo për faktin se ajo rruga ka që sa vite është në gjendje të mjerueshme dhe janë duke u ankuar me të drejt qytetarët tanë. Pyetja tjetër ka të bëjë me rrugën “Azem Hasani” në Smrekonicë. Një qytetar më është drejtuar me pyetje, që ka tre vite që është bërë kërkesa, por ajo rrugë është e pashtruar që 16 vite, ndërsa nuk është merr asnjëherë mendim i tyre ose asnjë përgjigje që çfarë do bëhet në atë rrugë. Pyetja tjetër është pse nuk po riparohen trotualet pas ndërhyrjeve nga ujësjellësi edhe po lejohet uzurpim i tyre nga ndërtimet e reja dhe lokalet po i detyrojnë njëfarë forme këmbësoret të ecin në mes të rrugës në ato rrugë ku lëvizin makinat. Pyetje tjetër ka të bëjë tek hapësirat ku do të largohen kabllot ajrore mbi kokat e qytetarëve në qendër të qytetit. Këtu duke përjashtuar sheshin, rrugëve të tjera ka shumë kabllot të cilat duheni me i parë dhe kur është planifikuar që ato të largohen. Pastaj çështje tjetër me rëndësi është ujë dhe kanalizim pyeta është nga kryetari i fshatit Studime e Epërme, kur do sigurohet furnizim e ujit të pijshëm, pasi që jemi në pra në vitin 2026 dhe ende kemi mungesë të ujit të pijshme. Pyetja tjetër është nga fshati Shallicë. Qytetarët bartin ujë me bidonë dhe përballen me mungesë të kanalizimit. Atëherë kur do të ketë përgjigje kjo zonë, ky fshat që do të ketë ujë dhe rregullim të kanalizimit. Gjithashtu ura e fshatit Stanoc i Poshtëm është buzë shembjes dhe rrezikon jetën e qytetarëve të këtij fshati. Pyeti kur do bëhet ndërhyrja e riparimit të asaj ure? Po ashtu kur do bëhet pastrimi dhe rregullimi i lumit “Sitnica”

nga pjesa e Stanocit deri tek fshati Mihaliq? Tutje kur do të bëhet me ndriçimin publik lagjet “Asllani dhe Duraku” në Stanoc të Poshtëm. Gjithashtu për drejtorët e Drejtorive të Kadastrit dhe Urbanizmit, ka ankesa nga qytetarët se pse banesat e blera nga pronarë legjitim nuk pranohen teknikisht prej tre vitesh edhe pse qytetarët paguajnë tatim në pronë rregullisht por nuk mund të regjistrojnë ato në emrin e tyre. Ndërkohë gjatë seancës sa ishim këtu faqja e “Vëzhguesit në Vushtrri” ka drejtuar pyetje drejtuar kryetarit të komunës. Po në këtë rast po i shkojmë tek Drejtorja e Shërbimeve Publike. Banjat publike të cilat janë tek pjesa e parkingut nëntokësor janë në gjendje të mjerueshme dhe askush nuk merret me këtë çështje për mirëmbajtjen e tyre. Gjithashtu tek rruga e Gojbulës, më saktë tek Xhamia ka mungesë të ndriçimit publik. Atje prindërit janë ankuar që fëmijët kalojnë në atë rrugë kur të përfundojmë mësimin në atë pjesë dhe nuk ka ndriçim, dhe për shkak edhe të zhvillimit të transportit që është mjaft i dendur në atë pjesë kanë frikë që mund t'ju ndodhë ndonjë e keqe fëmijëve të tyre. Gjithashtu ndoshta dy pyetje që do i drejtoj mund t'i përkasin nivelit qendror, por rrjedhimisht çfarë ka bërë komuna në këtë pjesë është nga rrethi i Emonës, deri tek pompa HIB, në rrugën magjistrale. Trotuari është i papastër dhe i mbuluar me dhe qytetari nuk është thënë që unë ju kam drejtuar kryetarit por nuk ka marrë përgjigje pasi ju ka thënë që i përket ministrisë. Po në këtë rast çfarë ka bërë komuna në këtë drejtim? Ai është drejtuar ministrisë për problematika të cilën qytetari i adreson. Gjithashtu tek Drejtorja e Bujqësisë një fermer më është drejtuar që ka dy vite që nuk është bërë pagesa e qumështit. Kur pritet pagesa e subvencioneve për litër të qumështit për fermerët. Gjithashtu kanalizim dhe gjendja tek varrezat në fshatin Druar është në gjendje të tmerrshme dhe ka mungesë të ndriçimit. Rrjedhimisht me të gjitha këto pyetje nga qytetarët edhe besoj që meritojnë një përgjigje nga ana e komunës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se dëshiroj të di se çka ka ndodhur me rezervuarin e ujësllësit të ndërtuar në fshatin Beçuk, i cili është planifikuar të furnizojë një pjesë të fshatrave të Artakollit, të cilat nuk kanë ujë të mjaftueshëm të pijes. Sipas deklaratave të kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi në fshatin Mihaliq janë montuar pompa të cilat bëjnë mbushjen e atij rezervuari. Mirëpo me të përfunduar zgjedhjet lokale është ndërprerë mbushja e rezervuarit. Pse ato pjesë të fshatrave nuk kanë ujë të pjesë? Çfarë ka ndodhur me pompat të cilat janë instaluar dy tre ditë para zgjedhjeve lokale dhe tani nuk janë funksionale? Edhe unë këtë pyetje e kam marrë prej qytetarëve.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit-vlerësoi se i vjen shumë mirë që këtu ka veç një “anëtare të kuvendit” se krejt qytetarët i paskan drejtuar pyetje vetëm Drita Dibranit. Lidhur me gjendjen e urës në fshatin Stanoc i Poshtëm njoftoj se është një vrimë shumë e vogël që është hapur para 10 apo 15 viteve, dhe shtoj se ajo rrugë edhe ajo urë është në kompetencën e ministrit e jo e komunës. Por kjo s'ka informata shumë a po e din? Duhet me dalë me informata dhe me fakte e mos me fol vetëm me hamendësime! A po e dini këtu jemi 31 asamblistë. Edhe nuk është mirë me dalë e veç me fol ashtu qysh ta merr mendja nuk është mirë se veç po na humb kohën edhe vota nuk fiton kështu hiç se e a po e din veç del qesharake. Kështu që të kisha lutur merru me lagjen tënde ku e ke mos bë dezinformata për fshatra të tjera se unë pikërisht jam Kryetar i Këshillit të fshatit Stanoc dhe rrjedhimisht i njohë më mirë problemet e atij komuniteti.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-duke referuar kuvendit adresoj disa pyetje ndër të tjera për Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit duke cekur se nuk është nuk është sjellë lista që e ka kërkuar edhe në seancën e kaluar për lejet ndërtimore dhe pëlqimeve ndërtimore. Nuk më ka arritur asnjë informatë lidhur me këtë çështje. Prandaj kërkoj që me i sjellë komplet listën e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore edhe afatet e dhënies së lejeve ndërtimore. Po ashtu kërkoj që listë të publikohet. Në këtë drejtim duhet të dihet saktë koha prej kur kanë aplikuar ndërtuesit

deri tek afati kur është dhënë leja ndërtimore. Kërkoj po ashtu të publikohet lista e projektuesve dhe e ndërtuesve ose të sillet me shkrim në kuvend.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-paraqiti përgjigje në pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit ku njoftoj, se blerja së veturave, gjatë mandatit të kaluar janë blerë katër vetura dy i jam blerë Drejtorisë së Shërbimeve Publike janë dy Opel Astra të cilat kanë kushtuar rreth 21.000 €. Është blerë një kombi për ndihmën e shpejtë me çmim afër 50.000 € dhe një PIKUP për Drejtorinë e Shëndetësisë me çmim 18.000 €. Domethënë plotësisht ishte i pavërtetë pretendimi që e ngriti që një veturë është blerë nga komuna me çmim 50.000 €. Anëtarën e kuvendit znj. Drita Dibrani e falënderoj për nismën që e kanë marrë me dëgjuar kërkesa e qytetarëve dhe faktikisht është përfaqësues e tyre në kuvend edhe paraprakisht para ekzekutivit komunal është mirë me i adresuar dhe me i kanalizuar pyetjet. Sa i përket rrugës prej fillimit të Nadakovcit deri në dalje, ne kemi kërkuar si komunë pasi që domethënë rruga kryesore është ndërtuar tash autostrada për Mitrovicë. Kemi kërkuar me marrë në shfrytëzim rrugën prej Nadakovcit derit në Smrekonicë. Ende nuk kemi ndonjë përgjigje që prej ministrisë deri në këtë kohë. Të gjitha mirëmbajtjet dimërore verore riparimet mbesin në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës. Sa i përket rrugës “Agim Hasani” këtu për ndriçim është e vërtetë në disa kode buxhetore kemi borxh për shkak që përmbaruesi s’i ka kursyer as kategorinë e komunalive vitin e kaluar. Po mundohem që diku deri muajin e gjashtë me i shlyer të gjitha borxhet edhe me pas gjithë qytetin ndriçim. Kabllot e rrymës po tentojmë çdo rrugë të re që planifikoj, me qenë me infrastrukturë nëntokësore edhe domethënë krejt rrugë e reja që do t’i ndërtojmë me bërë dislokimin e kabllave nëntokësore. Rrugë që nuk janë në planifikim mbesni kabllot ekzistuese. Për basenin e ujit pompat janë të vendosur janë të kyçura punojnë herë pas here, dhe në fshatin Stroc ka filluar furnizimi me ujë të pijes. Për fshatin Shallcë ka filluar me u shtri gypi i ujësjellësit. Për kanalizim duhet të veçohet se për cila lagje po bëhet fjalë se në disa lagje kemi filluar me intervenim në kanalizim, domethënë jo të gjitha lagje janë të përfunduar mirëpo një pjesë e fshati Shallcë është instaluar rrjeti i kanalizimit. Në fshatin Stanofc rruga prej Prelluzhës deri në Stanof nuk është në përgjegjësinë tonë. Pastrimi i lumit “Sitnica” ne me mundësitë buxhetore që i kemi, vazhduar deri në fshatin Petovë. Mendojmë me vazhduar pjesën kah fshati Dobërlluk , por edhe aty nevojitet ndihma e ministrisë pasi që lumenjtë janë në pronën e ministrisë dhe Asociacionit të Ujarëve. Banjat e parkingut nëntokësor munden me qenë një pjesë të ditës ose me ndonjë fesë munden me qenë në gjendje jo të mirë. Mirëpo çdo ditë Ndërmarrja “Përparim” e bënë pastrimin e tyre.

Mbledhja përfundoj në ora 14:30

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATA/DATUM/DATE	08.04.2026
PËR/ZA/TO:	KPF-Kuvendin e Komunës së Vushtrris
Përmes:	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi 
Nga/OD/FROM	Isuf Jashari, Drejtor i Financave 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2026

Të nderuar

Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2026 Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa ju prezanton Raportin Janar-Mars 2026 ,Raporti është i bazuar në planin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parasë publike për vitin 2026.

Shtojcë:Tabelat buxhetore

Emri i Komunës :	K.K.VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:	644								
Periudha raportuese	Janar - Mars 2026								
TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK									
Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese			Vjetore				Viti i kaluar
		Buxheti i planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhet të realizuar për PR	Buxheti i planifikuar për 2026	Buxheti i mbetur për 2026	Plani i reviduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11
Administrata dhe personeli	163	€	€	%	€	€	€	€	
Taksa administrative		10,000.00	11,743.00	117%	40,000.00	28,257.00	0.00	40,000.00	13,335.00
TOTAL		10,000.00	11,743.00	117%	40,000.00	28,257.00	0.00	40,000.00	13,335.00
Inspeksioni	166	€	€	%	€	€	€	€	€
Pranime teknike		3,000.00	1,945.00	65%	12,000.00	10,055.00	0.00	12,000.00	2,175.00
Gjodat e inspeksionit		1,500.00	150.00	10%	6,000.00	5,850.00	0.00	6,000.00	420.00
TOTAL		4,500.00	2,095.00	47%	18,000.00	15,905.00	0.00	18,000.00	2,595.00
Buxhet dhe Financa	175	€	€	%	€	€	€	€	€
Taksat e firmave		5,000.00		0%	20,000.00	20,000.00	0.00	20,000.00	
Tatimi në pronë		338,661.75	59,234.97	17%	1,354,647.00	1,295,412.03	0.00	1,354,647.00	179,866.43
TOTAL		343,661.75	59,234.97	17%	1,374,647.00	1,315,412.03	0.00	1,374,647.00	179,866.43
Arsimi	900	€	€	%	€	€	€	€	€
Shitja e prodhimeve									
Participimi në çerdrën e fëmijëve		30,000.00	40,758.00	136%	120,000.00	79,242.00	0.00	120,000.00	38,511.00
Shkolla e Mesme Teknike		7,500.00	20,222.00	270%	30,000.00	9,778.00	0.00	30,000.00	16,862.00
Shkolla e Mesme Profesionale		4,750.00	16,400.00	345%	19,000.00	2,600.00	0.00	19,000.00	9,180.00
TOTAL		42,250.00	77,380.00	183%	169,000.00	91,620.00	0.00	169,000.00	64,553.00
Gjeodezi dhe Kadastër	650	€	€	%	€	€	€	€	€
Të hyrat nga Gjeodezia dhe Kadastri		25,000.00	23,025.00	92%	100,000.00	76,975.00	0.00	100,000.00	17,130.80
Qiraja nga objektet publike		13,250.00	5,743.70	43%	53,000.00	47,256.30	0.00	53,000.00	7,165.84
TOTAL		38,250.00	28,768.70	75%	153,000.00	124,231.30	0.00	153,000.00	24,296.64
Kulturë, rini dhe sport	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Palestra e sportit		125.00	76.00	61%	500.00	424.00	0.00	500.00	650.00
Biblioteka		125.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	12.00
Shtëpia e Kulturës		125.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	
TOTAL		375.00	76.00	20%	1,500.00	1,424.00	0.00	1,500.00	662.00
Shërbime publike	180	€	€	%	€	€	€	€	€
Ndalja e veturave ne rruge		500.00	1,515.75	303%	2,000.00	484.25	0.00	2,000.00	2,345.00
Regjistrimi i automjeteve		45,000.00	46,420.00	103%	180,000.00	133,580.00	0.00	180,000.00	40,990.00
Taksat e mbeturinave		221,500.00	295,335.42	133%	886,000.00	590,664.58	0.00	886,000.00	179,648.80
TOTAL		267,000.00	343,271.17	129%	1,068,000.00	724,728.83	0.00	1,068,000.00	222,983.80
Prokurimi	470	€	€	%	€	€	€	€	€
Ndryshimi i destinimit të tokës		12,500.00	21,687.00	173%	50,000.00	28,313.00	0.00	50,000.00	25,646.21
Leje pune									
Shitja e drujve									
TOTAL		12,500.00	21,687.00	173%	50,000.00	28,313.00	0.00	50,000.00	25,646.21
Shëndetësi	700	€	€	%	€	€	€	€	€
Participim		16,250.00	14,658.00	90%	65,000.00	50,342.00	0.00	65,000.00	17,174.00
Participim QPS		875.00	2,329.00	266%	3,500.00	1,171.00	0.00	3,500.00	1,718.00
TOTAL		17,125.00	16,987.00	99%	68,500.00	51,513.00	0.00	68,500.00	18,892.00
Urbanizmi	660	€	€	%	€	€	€	€	€
Lejet e ndërtimeve		187,500.00	126,764.71	68%	750,000.00	623,235.29	0.00	750,000.00	309,407.08
leje mjedisore		25,000.00	19,728.81		100,000.00				62,319.86
Legalizim I Objekteve		2,500.00	1,468.01		10,000.00				4,437.44
Rrenim I objekteve			148.68						
Shfrytëzimi i pronës Publike		6,250.00	298.50	5%	25,000.00	24,701.50	0.00	25,000.00	344.60
TOTAL		221,250.00	148,408.71	67%	885,000.00	647,936.79	0.00	775,000.00	376,508.98
Gjodat e pyjeve	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Të hyrat tjera				0%		0.00	0.00	0.00	
TOTAL		0.00	0.00	0%	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		956,911.75	709,651.55	74%	3,827,647.00	3,117,995.45	0.00	3,717,647.00	929,339.06

Sqarim:
Planifikimi i të hyrave vetanake për periudhën : Janar-Mars 2026 është - 956.911.75 €, realizim është - 709,651.55, shprehur në përqindje 74% realizimi,

Emri i Komunës :	VUSHTRRI									
Kodi i Komunës:	644									
Periudha raportuese	Janar - Mars 2026									
PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE										
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VIETORE					
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2023	Buxheti i mbetur për 2026	Plani i reviduar 2026	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Viti i kaluar	
Zyra e Kryetarit	160	151,385.54	122,981.19	81%	444,641.20	321,660.01	€	€	€	139,876.34
Administrata dhe personeli	163	191,441.23	185,880.22	97%	645,697.72	459,817.50	0.00	645,697.72	180,758.49	
Inspektimet	166	51,331.86	50,456.86	98%	175,105.80	124,648.94	0.00	175,105.80	34,805.77	
Prëkurimi	167	15,431.20	14,746.20	96%	55,518.02	40,771.82	0.00	55,518.02	10,887.82	
Zyra e Kuvendit Komunal	169	101,700.34	100,431.66	99%	295,848.14	195,416.48	0.00	295,848.14	66,314.67	
Buxheti dhe financat	175	90,451.44	77,611.04	86%	251,410.60	173,799.56	0.00	251,410.60	50,519.37	
Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjence	180	2,525,197.26	2,289,481.74	91%	5,001,099.97	2,711,618.23	0.00	5,001,099.97	1,839,605.01	
Zyra lokale e komuniteteve	195	39,733.18	39,223.80	99%	113,787.80	74,564.00	0.00	113,787.80	17,820.81	
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	1,144,679.68	636,575.84	56%	2,073,817.00	1,437,241.16	0.00	2,073,817.00	1,058,977.14	
Gjendjezi dhe Kadastro	650	43,920.21	43,320.21	99%	142,736.40	99,416.19	0.00	142,736.40	33,022.37	
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,971,802.86	1,919,435.38	97%	2,991,159.80	1,071,724.42	0.00	2,991,159.80	564,734.05	
Shëndetësi primare	730	1,096,949.77	974,404.39	89%	3,380,811.40	2,406,407.01	0.00	3,380,811.40	963,065.37	
Shërbimet sociale rezidenciale		325,300.32	311,785.42	96%	595,827.80	284,042.38	0.00	595,827.80	70,123.89	
Kulturë, firi, sport	850	390,163.00	382,540.15	98%	991,052.38	608,512.23	0.00	991,052.38	141,344.74	
Arsimi	920	4,800,760.02	4,359,013.48	91%	13,149,282.86	8,790,269.38	0.00	13,149,282.86	3,481,412.49	
TOTALI		12,940,247.91	11,507,887.58	89%	30,307,796.89	18,799,909.31	0.00	30,307,796.89	8,653,268.33	

Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti i planifikuar për periudhen Janar-Mars 2026.

Planifikimi është 12,940,247.91. Realizimi i shpenzimeve është 11,507,887.58 euro, Realizimi 89%.

Kodi I komunës:
 Periudha raportuese

VUSHTRRI
 644
 Janar - Mars 2026

KODI	Mallrat dhe shërbimet	2025	2026
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit		980.00
13131	Para xhepi-mëdijë për udhëtime zyrtare brenda vendit	16.00	823.00
13141	Shpenzimet të vogla -para xhepi		2,652.80
13142	Akomodimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit		900.00
13143	Shpenzimet tjera e udhëtimit zyrtar jasht vendit	2,378.00	500.00
13310	Shpenzimet për internet	1,687.46	2,566.07
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	10,795.97	12,426.22
13330	Shpenzimet postare	182.10	314.40
13340	Kablo optike		995.00
13420	Shërbimet e perfaqsimi - avokaturë	9,471.70	
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	4,584.94	2,115.80
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	4,607.45	1,925.00
13445	Shërbime të veçanta		4,110.00
13450	Shërbime të shtypje / printim		6,972.00
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	1,715,542.48	807,849.37
13470	Shërbime teknike	9,061.38	23,894.91
13480	Shpenzimet e anëtarësimit	25,240.25	
13502	Telefonat		
13503	Kompjuterët	1,257.00	
13509	Pajisjet e tjera	17,855.00	5,113.83
13610	Furnizime për zyrë	16,583.10	33,453.19
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	16,852.75	19,915.93
13630	Furnizime mjekësore	9,362.51	15,590.70
13640	Furnizime pastrimi		10,211.82
13650	Furnizim me veshmbathje		
13655	Furnizim me preparate kimike		198.25
13710	Vaji	9,000.00	
13720	Nafte për ngrohje qendrore		15,943.57
13760	Dru dhe prodhimet e drurit për ngrohje	195,681.36	151,719.98
13780	Derivate për automjete gjenerator dhe makineri	9,596.52	31,309.59
13790	Gas natyror		
13810	Avanc për para të imta	1,850.00	2,300.00
13820	Avanc për udhëtime zyrtare	6,488.97	2,452.69
13918	Provizion për tarifa të ndryshme	1,602.50	
13950	Regjistrimi i automjeteve	3,169.09	1,545.00
13951	Sigurimi i automjeteve	481.26	3,483.29
13954	Kontrolli teknik	480.00	
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	9,228.40	8,366.00
14020	Mirembajtja e ndërtesave		1,680.00
14023	Mirembajtja e shkollave	32,500.00	
14032	Mirembajtja e rrugëve lokale	5,016.85	711,398.70
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve	28,973.80	26,718.62
14060	Mirembajtja rutinore		262,561.00
14110	Qiraja ndërtesa	450.00	
14130	Qiraja - pajisjet	2,358.04	6,879.78
14160	Qiraja për automjete	11,442.24	22,884.48
14220	Botimet e publikimeve		475.00
14230	Shpenzimet për informim publik		2,724.00

14310	Kompensimi I përfaqësimit brenda vendit	9,558.90	7,390.05
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	335,768.29	350.00
14415	Pagesat për tarifat-vendimet gjyqësore- përmbarimore	16662.5	252.75
13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME		2,525,786.81	2,213,942.79

14			
13210	Energjia elektrike	91,995.05	205,763.07
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	9,333.95	14,853.15
13230	Mbeturinat	8,724.00	6,089.10
13250	Telefonia fikse	2,354.38	367.36
13260	Pagesa-vendime gjyqësore	5,500.00	
14 TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE		117,907.38	227,072.68

20	SUBVENCIONET		
21110	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE	79,334.86	31,700.00
21200	SUBVENCIONE PËR ENTITETET JOPUBLIKE	271,533.29	151,057.97
	TRANSFERE PËR ENTITETET PUBLIKE		1,440.00
22202	TRANSFERE PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	269,870.00	348,708.97
	LIBRA PER NXENES		300.00
22298	PAGESAT PËR SHËRBIMET E VARRIMIT	7,000.00	9,720.00
22299	QIRAJA PËR RASTET SOCIALE	600.00	6,000.00
22300	VENDIMET GJYQËSORE	244,594.60	183,440.30
			13,200.00
20 TOTALI I SUBVENCIONEVE		872,932.75	745,567.24
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE		3,516,626.94	3,186,582.71

ri i Komunës :	VUSHTRRI			
Si i Komunës:	644			
		Janar - Mars 2026		

Shprehja raportuese

RMBLEDHJA E SHPENZIMEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE

Përshkrimi	BUXHETI	SHPENZIMET PËR PERIUDHËN	MJETET E LIRA	PËRQINDJA E REALIZIMIT TË BUXHETIT
644 VUSHTRRI	5,621,622.24	3,274,628.02	2,347,094.22	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,621,622.24	3,274,628.02	1,948,083.42	0.00
17524 BUXHETI - VUSHTRRI	332.00	0.00	332.00	0.00
60405 ASFALTIMI I RRUGES PANTIN-ASHLAN	331.00	0.00	331.00	0.00
60403 RIPARIM SHF KRASNËQ.POSHTME	1.00	0.00	1.00	0.00
18024 SHËRBIMET PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - VUSHTRRI	1,246.69	0.00	1,246.69	0.00
71935 RREGULLIMI I SHESHIT HSAN PRISHTINA	37.00	0.00	37.00	0.00
72228 RREGURRUGES BAHRI KUQI SEG.1	375.52	0.00	375.52	0.00
83124 FOND.BASHKFIN.SHTR.RR.KUBEZA	2.00	0.00	2.00	0.00
86140 FONDI BASHKFINANCIMIT SHTRURJA E RRUGVE ME KUBE	728.07	0.00	728.07	0.00
93129 PTK PER RR.NE L.BUN SOP.F.SAMA	104.00	0.00	104.00	0.00
18184 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - VUSHTRRI	1,330,938.68	883,664.92	429,913.14	0.00
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE (NENI 40 LMFP)	600,000.00	598,025.44	1,974.56	0.00
47826 NDËRTIMI I STACIONIT TË AUTOBUSEVE	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
51819 Ndërtimi i kanalizimeve në Vushtri, Smadroxhë, Maxhunaj, S	125,000.00	100,000.00	25,000.00	0.00
51826 Blerja e veturave për administratën komunale - Vushtri	80,000.00	52,639.48	10,000.00	0.00
53182 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NEPESTOVE	15,000.00	12,000.00	3,000.00	0.00
53193 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË GOJBULË	15,000.00	12,000.00	3,000.00	0.00
53220 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË STANOC TË EPËRM - STANOC TË POSHTËM	25,000.00	20,000.00	5,000.00	0.00
53228 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË MIHALIQ	15,000.00	12,000.00	3,000.00	0.00
53231 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË AKRASHTICË - BALINÇE	25,000.00	20,000.00	5,000.00	0.00
53259 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË PANITINË - OSHLAN	15,000.00	12,000.00	3,000.00	0.00
53374 NDËRTIMI I URËS NË LUM MADH	30,000.00	0.00	30,000.00	0.00
53603 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË KOLLE	10,000.00	8,000.00	2,000.00	0.00
54893 NDËRTIMI E RR. ME KUB BETONI BESHIR KRASNËQI, JASHAR JASHARI	124,837.00	0.00	124,837.00	0.00
54917 NDËRTIMI I TROTUAREVE FSHATI DOBERLLUKË, STANOC, AKRASHTICË	14,924.00	0.00	14,924.00	0.00
54946 NDËRTIMI I STACIONIT TË POMPIMIT, RRJETIT PRIMAR REZERVUARËV	100,000.00	0.00	100,000.00	0.00
56322 Ndërtimi i kanalizimit në Druar	15,000.00	13,000.00	2,000.00	0.00
56325 Ndërtimi i kanalizimit në Banjske	15,000.00	12,000.00	3,000.00	0.00
56330 Ndërtimi i kanalizimit në Shalc	15,000.00	12,000.00	3,000.00	0.00
56358 Ndërtimi i vigut në Novolan dhe shetitores	40,000.00	0.00	40,000.00	0.00
57187 NDËRTIMI I PARKUT TË "DYNEKU"	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019	3,985.65	0.00	3,985.65	0.00
92111 PERFORMANCA KOMUNALE 2021	6,285.73	0.00	6,285.73	0.00
93195 NDËRT.PIK.PRITËSE PER AUTOB.PRI-ZHI-BIV-STR	906.20	0.00	906.20	0.00
47024 BUJQËSIA - VUSHTRRI	894,789.00	261,464.86	633,324.14	0.00

00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE (NENI 40 LMFPF)	200.796.00	200.432.00	364.00	0.00
4062 NGRITJA E PEMISHTEVE	991.00	0.00	991.00	0.00
4060 PROJEKTET E NEBASHKEFINANCIAM E DORHATORE	438.000.00	0.00	438.000.00	0.00
52200 RREGULLIMI DHE PASTRIMI I LUMIT LLAP-SILVICA	155.000.00	61.032.86	93.967.14	0.00
50302 Rregullimi dhe pastrimi i lumit "Silvica" Vushtrri- Smrkorë	100.000.00	0.00	100.000.00	0.00
6162 NGRITJA E SERAVE	2.00	0.00	2.00	0.00
66425 PLANIFIKIMI URBANIZIMI INSPERKSIONI - VUSHTRRI	2,676,368.00	1,655,412.60	635,946.40	0.00
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE (NENI 40 LMFPF)	1,063,014.68	1,051,783.28	1,231.40	0.00
53207 NDERTIMI I RRUJG "BEKIM BERISHA ABEJA"	79,018.34	49,018.34	30,000.00	0.00
53262 NDERTIMI I RRUJG "AVNISARAÇI" VICIANA	12,600.00	12,600.00	0.00	0.00
53274 RREGULLIMI I RRUJG "ISAK HALIL" ME INFRASTRUKTURE PERCJELLESE	100,000.00	0.00	50,000.00	0.00
53270 NDERTIMI I RRUJG "LUMNI SURDULLI"	72,011.00	62,011.00	10,000.00	0.00
53344 RIKONSTRUMIMI I BULEVARDIT "ADEMI JASHARI" DHE LIDHJA ME	110,000.00	0.00	110,000.00	0.00
54750 REHABILITIMI I RRUGEVE NE VERRNICE-SHALLO, AKRASHTICE, BUKOS	90,000.00	70,000.00	20,000.00	0.00
54754 REHABILITIMI I RRUGEVE NE SMREKONICE DOBERLLUKE, SLLA TINE P	40,000.00	40,000.00	0.00	0.00
54775 REHABILITIMI I RRUGEVE NE BIVOLAK ZHELIVODE, STROG	90,000.00	70,000.00	20,000.00	0.00
54790 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE DUNINCE, MAXHURIAJ, STANOC, LUM	110,000.00	0.00	110,000.00	0.00
54799 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE GRACE, PRELUZHE	80,000.00	60,000.00	20,000.00	0.00
54801 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE STUDIME E LAET, CECELI, SAMADRE	220,000.00	150,000.00	70,000.00	0.00
54820 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE STROG, BEQUK, GLLAVOTIN, BIVOL	140,000.00	80,000.00	60,000.00	0.00
54834 NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE BECIC, DUBOC	70,000.00	0.00	15,000.00	0.00
56290 Ndanimi i rrugës Bfaraçak te varrezat	94,714.00	0.00	44,714.00	0.00
57199 RINDERTIMI DHE ZQJERIMI I RRUGEVE ME INFRASTRUKTURE PERCJELLE	25,000.00	0.00	25,000.00	0.00
57199 NDERTIMI I RRUJG "2 MAJI" ME INFRASTRUKTURE PERCJELLESE- STUD	180,000.00	0.00	50,000.00	0.00
74450 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - VUSHTRRI	84,428.00	0.00	84,428.00	0.00
57171 DEPO PËR OBJEKTE SHËNDETËSORE - VUSHTRRI	84,428.00	0.00	84,428.00	0.00
75617 SHËRBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRRI	246,000.00	229,879.92	120.08	0.00
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE (NENI 40 LMFPF)	230,000.00	229,879.92	120.08	0.00
53925 DLERJA E VETURES PER SHËRBIMET REZIDENCIALE	15,000.00	0.00	0.00	0.00
57171 SHËRPIA E KOMUNITETIT PËR PERSONA TE MOSHËR - VUSHTRRI	0.00	0.00	0.00	0.00
85024 SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRRI	332,040.02	244,105.72	87,040.02	0.00
52825 RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I OBJEKTIT "ARKI I VJETËR" ISH F	41,000.00	34,105.72	6,000.00	0.00
54727 RREGULLIMI I MEMORIALEVE NE GLLAVOTIN, REZNIK, BECIC, DUBOC	91,040.00	70,000.00	21,040.00	0.00
54735 NDERTIMI I RIKONSTRUMIMI I FUSHAVE SPORTIVE MAXHURIAJ, LUMMADH	200,000.00	140,000.00	60,000.00	0.00
92090 NGRITJA E PERFORMANCES 2010	0.02	0.00	0.02	0.00
92670 ARSIMI PËR FILLOR CËRDHET - VUSHTRRI	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
57194 NDERTIMI I CËRDHEVE IQYTET, LUMMADH, SMREKONICE, MAXHURIAJ	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
93690 ARSIMI I FILLOR - VUSHTRRI	146,755.00	0.00	65,000.00	0.00
53024 NDERTIMI I SHFMU "MUSTAF VENHARI"	100,756.00	0.00	20,000.00	0.00
5694 NDERTIMI I SHFMU "EMIN DURAKU" - NOVOLAN	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00
57192 NDERTIMI I SHKOLLËS "NAIM FRASHERI" - VUSHTRRI	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00
57193 NDERTIMI I SHKOLLËS "7 MARS" BUKOSH	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00
94690 ARSIMI I MESËM - VUSHTRRI	734.05	0.00	734.05	0.00
93222 RREGULLIMI I SHKOLLËS BAHRI HAXHA	577.05	0.00	577.05	0.00
95104 FURHIZ MJETE PER PUNTOR SALGATOR-AXHUSTATORËVE	157.00	0.00	157.00	0.00
Totali i Përgjithshëm	5,621,622.24	3,274,528.02	1,948,083.42	0.00



Sqarim: Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike në investime kapitale është si vijon:
 Buxheti i planifikuar në investime kapitale për vitin 2026 është 5,621,622.24 euro, realizimi është 3,274,528.02 euro, apo 58.24% realizimi, shumica e mbetur për periudhat në vijimë në vlerë 1,948,083.42 euro, janë në procedurë të realizimit.
 Vrejtje: Për dallim nga vitet të tjera të investimit kapitale, theksoj se në vitin 2026, Ministria e Punës dhe Transfereve ka hapur kodin ekonomik ekonomik 00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE (NENI 40 LMFPF), dhe nga projektet e planifikuara kanë ekzekutuar shumën 2,090,120.62 euro për Vendime Gjyqësore Përmbarimore.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

DATË:	16.04.2026
PËR:	Kuvendin e Komunës
PROPOZUES:	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës së Vushtrrisë 
HARTUES:	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtori i Drejtorisë: 
TEMA:	Akt – përcjellës

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Ky dokument është hartuar nga komisioni i themeluar me vendimin nr. 5767/26 të datës 06.02.2026 të kryetarit të komunës dhe i njëjti i ka kaluar të gjitha filtrat ligjor, duke përfshirë edhe diskutimin publik nga data 10.03.2026 deri më 26.03.2026.

Konsultimi publik është mbajtur me datën 23.04.2026 ku kemi pranuar vërejtjet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Duke konsideruar se ky dokument i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të njëjtën po ua procedojmë për shqyrtim në KPF dhe të njëjtën për aprovim nga Kuvendi i Komunës.

Me respekt!



Në mbështetje të nenit 12.2 pika c, nenit 17, pika f, nenit 40.2, pika a dhe g, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 04.06.2008, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19.1, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.06.2008, neni 15 dhe 34 të Ligjit Nr. 04/L – 60 për Mbeturina i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 29.06.2012, Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina e shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.09.2022 dhe nenit 13 nën par. 1.6, nenit 18 nën par. 1.1 të Statutit Nr. 209/22 të Komunës së Vushtrrisë të miratuar me datë 06.09.2022 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur me __. __.2026, miratoi këtë:

DRAFT – RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Kjo rregullore përshkruan përmbajtjen dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit publik, mënyrën e menaxhimit të mbeturinave në lidhje me shërbimit publik të mbledhjes së mbeturinave komunale, komerciale dhe jo vetëm, mënyrën dhe kushtet e përcaktimit të tarifën për pagesën e mbeturinave komunale për amvisëri dhe biznese.

Neni 2

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, si dhe përcakton vlerën (shumën) e tarifës për mbeturina, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm financiar me cilësi të lartë, dhe ekonomikisht të efektshëm të mbledhjes së mbeturinave komunale në Komunën e Vushtrrisë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtja e interesit publik.
2. Me këtë rregullore përcaktohet sistemi, mënyra e mbledhjes, ndarjes, përpunimit, llojin, mënyrën e shpërndarjes dhe të vendosjes së kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku bëhet mbledhja e mbeturinave dhe transportimi i tyre.

Neni 3 Fushëveprimi

Kjo Rregullore definon kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave për të zvogëluar sasinë që deponohet, shkarkimin, grumbullimin, transportimin dhe deponimin. Gjithashtu në kuadër të fushë veprimtarisë bënë pjesë edhe ndarja dhe aktivitetet e riciklimit, me qëllim të ruajtjes (mbrojtjes) së mjedisit jetësor në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 4 Përkufizimet

1. Përkufizimet në këtë rregullore kanë këtë domethënie:

- 1.1 **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi - zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh ose është i detyruar ta hedh.
- 1.2 **Menaxhimi i mbeturinave** – (në tekstin e mëtejshëm i referohemi MM), aktivitetet për evitimin, reduktimin e prodhimit të mbeturinave, ndikimit të tyre në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së tyre.
- 1.3 **Operatori** – nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
- 1.4 **Ndërmarrja** – nënkupton N.P.L “Përparimi” Sh. A.
- 1.5 **Leje përkatëse mjedisore** - nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
- 1.6 **Person** - person fizik ose juridik i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 1.7 **Konsumatori** – person fizik dhe juridik të cilëve u ofrohen shërbime për mbeturinat.
- 1.8 **Ri-përdorimi** – përdorim i serishëm përmes së cilit çdo produkt apo komponentë e cila nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim.
- 1.9 **Riciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;
- 1.10 **Mbledhja** – grumbullim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 1.11 **Mbledhja e selektuar** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet

në mënyrë të ndare në lloje, të klasifikuara sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

- 1.12 Gjenerues i mbeturinës** – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose operime tjera të cilat rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 1.13 Zotëruesi i mbeturinës** - gjeneruesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
- 1.14 Ekonomitë familjare rezidente** - Ekonomitë familjare rezidente - njesitë familjare që banojnë në mënyrë të përhershme në një objekt banesor brenda territorit të komunës dhe që gjeneron mbeturina komunale në mënyrë të rregullt duke qenë subjekt i shërbimeve të mbledhjes dhe pagesës së tarifës për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave.
- 1.15 Ekonomitë familjare jorezidente** - njësi familjare që nuk banon në mënyrë të përhershme në një objekt banesor brenda territorit të komunës, por e përdorë atë në mënyrë të përkohshme ose sezonale. Duke gjeneruar mbeturina komunale vetëm gjatë shfrytëzimit të objektit.
- 1.16 Ekonomitë familjare pasive** - njesi familjare ose objekt banesor që nuk është i banuar dhe që nuk gjeneron mbeturinë komunale.
- 1.17 Mbeturina komunale** - nënkupton: mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliet; mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake, dhe mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.
- 1.18 Bio-mbeturina** - nënkupton mbeturinat e biodegradueshme të kopshteve dhe parqeve, mbeturinat ushqimore dhe të kuzhinës nga amvisëritë, zyrat, restorantet, shitësit me shumicë, mensat etj.
- 1.19 Mbeturina e parrezikshme** - mbeturina që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe nuk kanë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
- 1.20 Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, si dhe çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi.
- 1.21 Mbeturina inerte** - mbeturina të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si mbeturinat që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut, ku i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës (mbetjet ekotoksike) duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave

- sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 1.22 Mbeturinë e vëllimshme** - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.
- 1.23 Mbeturina ndërtimi dhe rrënimi** – nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes.
- 1.24 Kontratë për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale** – nënkupton kontratën në të cilën mbledhësi i mbeturinave bën mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komerciale për llogari të gjeneruesit të mbeturinave
- 1.25 Faturë** – nënkupton një dokument i besueshëm i cili i dërgohet debitorit për përmbushjen e detyrimit nga ana e tij.
- 1.26 Qendra grumbulluese** – Lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të tyre.
- 1.27 (3R)** – reduktim, ripërdorim, riciklim
- 1.28 Gjinia** – fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.
- 1.29 Njëjës/shumës** - njëjësi do të nënkuptojë shumësin dhe anasjelltas.

Neni 5

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

1. Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave bëhet nga personi i pajisur me leje mjedisore komunale dhe i kontraktuar nga komuna, prej gjeneruesit e deri në deponinë e mbeturinave.
2. Mbeturinat e rrezikshme, para se të mblidhen dhe transportohen, klasifikohen sipas llojeve të tyre, pastaj mblidhen dhe transportohen.
3. Nëse gjatë transportimit të mbeturinave ndodhë ndotja, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthej në gjendje të mëparshme.

Neni 6

Menaxhimi i mbeturinave nga Komuna

1. Përgjegjësitë e Komunës në lidhje me menaxhimin e mbeturinave janë:
 - 1.1 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
 - 1.2 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
 - 1.3 Kontraktimi i shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit përkatës të prokurimit, përzgjedh operatorët e pajisur me leje përkatëse mjedisore për secilin shërbim veçmas, apo si tërësi në lidhje me mbledhjen, grumbullimin, magazinimin e mbeturinave, transportimin e mbeturinave komunale, komerciale dhe të gjitha llojet e tjera të mbeturinave.
 - 1.4 Formimi i sektorit për menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

- 1.5 Monitorimi dhe udhëzimi për ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave bëhet nga Sektori për menaxhimin e mbeturinave.
- 1.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të qendrës së paketimit të mbeturinave të riciklueshme, e cila është ndërtuar në fshatin Bukosh.
- 1.7 Të bëjë identifikimin dhe nëpërmjet operatorëve ekonomik largimin e deponive ilegale të mbeturinave.
- 1.8 Përcaktimi i vendndodhjes të vendosjes së kontejnerit dhe llojit të kontejnerëve që do të shfrytëzohet në bashkëpunim me operatorin ekonomik dhe palët e treta.
- 1.9 Promovimi i reduktimit të sasisë së mbeturinave (përmes metodave të 3R, ndarjes në burim dhe kompostimit shtëpiak).
- 1.10 Ngritja e vetëdijes publike - pjesëmarrja aktive e qytetarëve në zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave.
- 1.11 Planifikimi buxhetor për funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
- 1.12 Përcaktimi i tarifës dhe mënyrës së arkëtimit të mjeteve financiare caktohet me këtë rregullore.
- 1.13 Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për menaxhim të mbeturinave çdo 31 mars të vitit pasues.
- 1.14 Sigurimi i kushteve të barabarta për veprim për operatorët publik dhe privat, mirëpo që operatori ekonomik publik në pajtim me nenin 9 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ka përparësi, e që rast përjashtim mund të jetë ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme kur operatori ekonomik publik nuk mund të ofrojë shërbim, mund të vie në shprehje të kontraktohet një operator privat i pajisur me leje mjedisore përkatëse. Pajisë me leje mjedisore komunale, operatorët që merren vetëm me bartjen dhe transportimin e mbeturinave komunale.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave

1. Gjeneruesi i mbeturinave ka të drejtë të kërkojë që t'i bëhet zbrazja e kontejnerit.
2. Gjeneruesi i mbeturinave ka të drejtë të kërkojë që me rastin e zbrazjes së kontejnerit nga operatori i kontraktuar të bëjë edhe dezinfektimin e të njëjtit së paku gjashtë (6) herë në muaj, dhe të bëjë pastrimin e hapësirës përreth kontejnerit.
3. Gjeneruesi i mbeturinave ka të drejtën e parashtrimit të ankesës në rastet kur nuk bëhet mbledhja e mbeturinave që ai gjeneron.
4. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të përfshihet në sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe ka të drejtë qasjeje në shërbimin e ofruar.
5. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të paguajë për shërbimin që pranon tarifën e përcaktuar në shtojcën e kësaj rregulloreje, dhe gjeneruesi paguan në bazë të parimit "Ndotësi Pagan".
6. Gjeneruesi i mbeturinave duhet t'i mundësojë qasje operatorit në vendin e dorëzimit të

mbeturinave.

7. Gjeneruesi i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuara sipas planit lokal të menaxhimit të mbeturinave.
8. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të bëjë hedhjen e mbeturinave në vende të caktuar nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave.
9. Gjeneruesi i mbeturinave duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave.
10. Gjeneruesi i mbeturinave duhet të paraqes ndryshimin e të dhënave (siç janë: shitja e pronës, trashëgimia dhe dëshmitë tjera relevante).
11. Regjistrimet e reja të amvisërive në sistem bëhen në bazë të këtyre kriterëve:
 - 11.1 Para kontrata dhe kontrata e shitblerjes.
 - 11.2 Blerësi duhet të regjistrohet në sistem, nëse nuk është i regjistruar paraprakisht nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa shitësit vetëm adresa i ndryshohet.
 - 11.3 Regjistrimi i njehsorit të rrymës elektrike.
 - 11.4 Konfirmimi i pagesës së faturës për mbeturina për vendbanimin paraprak.
 - 11.5 Dokumenti identifikues.
12. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj tarifën e shërbimit.
13. Gjeneruesi i mbeturinave, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër.
14. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të regjistrohet në listat e shërbimit të gjeneruesve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
15. Gjeneruesi i mbeturinave detyrohet që mbeturinat t'i ndajë dhe t'i vendos sipas sistemit të përcaktuar në planin e operimit të përcaktuar nga komuna.
16. Ndërmarrjet prodhuese, ndërtuese dhe tjera në cilësinë e gjeneruesve të mbeturinave, obligohen që Komunës së Vushtrrisë, t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 8

Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave

1. Sistemit të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale në Komunën e Vushtrrisë i nënshtrohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që banojnë, veprojnë ose posedojnë pronë të paluajtshme në territorin e Komunës.
2. Detyrimi për pagesën e tarifës së mbeturinave lind nga momenti i ofrimit të shërbimit në zonën kadastrale përkatëse, nëpërmjet vendosjes së kontejnerëve, dhe hedhjes së mbeturinave nga gjeneruesit e mbeturinave.
3. Mungesa e një kontrate të shkruar individuale ndërmjet gjeneruesit të mbeturinave dhe operatorit nuk e liron gjeneruesin nga detyrimi për pagesën e tarifës mujore të miratuar nga Kuvendi Komunal.
4. Ky detyrim rrjedh nga neni 13 dhe neni 34 par. 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.
5. Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

5.1 Kategoritë e amvisërive ndahen në nën kategoritë si në vijim:

5.1.1 Familjet rezidente;

5.1.2 Familjet jo rezidente nga diaspora;

5.2 Kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave që rrjedhin nga bizneset të ndarë në nën kategoritë si në vijim:

5.2.1 Nënkatëgoria e parë - përfshinë veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese me pagesë mujore në vlerë prej 10.00 €. Kjo nënkategori përfshin: kioskat dhe shitoret e dyqanet e madhësisë së ngjashme me të kioskave; shitoret e dyqanet e vogla si shitësit e kafesë, disqeve, kozmetikës, syzeve, thjerrëzave dhe suvenireve (dhuratave) të vogla, axhustatorët (salduesit), argjendaritë, orëtarët, agjencitë turistike, rrobaqepësit, këpucëtarët, fotografët, butikët, libraritë, dyqanet e pastrimit kimik, këmbimoret, llamarinë-punuesit, zyrat e shërbimeve profesionale deri në 20m², siç janë zyrat e vogla të avokatëve, noterëve, përmbaruesve, këshilltarëve financiarë; veprimtaritë e tjera të vogla siç janë parkingjet, qendrat e video-lojërave dhe kurset e gjuhëve dhe teknologjisë, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.2.2 Nënkatëgoria e dytë - përfshinë subjekte të mesme dhe të mëdha komerciale dhe industriale me kosto të ulët të shërbimit siç janë: lokalet për shitjen e mjeteve motorike (auto sallonet) dhe mirëmbajtjen e automjeteve (duke përjashtuar limarët), frizerët dhe lokalet e tjera të kujdesit personal, barnatoret, ordinancat, klinikat e vogla dhe ambulancat stomatologjike me deri në dy karrige (për mbeturina komunale), serviset e pajisjeve teknike dhe elektronike, sallonet e sanitarisë, qendrat e fitnesit, shitoret e vogla përfshirë shitoret sanitare, të mobileve, të auto-pjesëve, të tekstilit dhe këpucëve; ndërmarrjet publike, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.2.3 Nënkatëgoria e tretë - përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të moderuar të shërbimit siç janë: kafiteritë dhe lokalet e vogla të ushqimit të shpejtë, shitoret ushqimore dhe bodrumet e pijeve, zyrat e shërbimeve profesionale me madhësi mbi 20m², siç janë zyrat e avokatëve, noterëve, përmbaruesve, bankat, këshilltarëve financiarë, sallonet e mëdha të mobilieve, qendrat sportive, veprimtaritë zejtare më të rënda si limarët dhe xhamaprerësit; spitalet (vetëm sa i përket mbeturinave komunale), pompat e benzinës me mini-market, ndërmarrjet publike, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.2.4 Nënkatëgoria e katërt - përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale industriale me kosto të lartë të shërbimit siç janë: dyqanet e mëdha (super marketet) dhe furrat e bukës dhe byrektoret, restorantet (për ahengje familjare, salla dasmash etj.), gjellëtoret, klubet e natës, veprimtaritë hoteliere, pompat e benzinës me restorant, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

- 5.2.5 Nënkatëgoria e pestë** - përfshin subjektet ekonomike dhe komerciale që ushtrojnë veprimtari të specializuar në trajtimin, përpunimin, si dhe shitjen me shumicë ose pakicë të mishit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë: mishoret, pikat e specializuara të shitjes së mishit, njësitë e përpunimit dhe paketimit që hudhin eshtrat.
- 5.3 Kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave që rrjedhin nga institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera:**
- 5.3.1** Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit që përfshinë: Zyrën e Punësimit, Agjencioni për Regjistrim Civil, Ambulantet e Mjekësisë familjare, Qendra për Punë Sociale, Zyrrat e Partive Politike, dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
- 5.3.2** Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të mesme të shërbimit që përfshinë: Shkollat fillore dhe të mesme, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare, Spitali Regjional Sheikh Zayed sa i përket mbeturinave komunale, Halla e Sporteve – Jeton Tërstena – Tota, Stadiumi i Futbollit – Ferki Aliu, Stadiumi i Futbollit në fsh. Doberlluke, Fakulteti i Sigurisë Publike, Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri, dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
- 5.3.3** Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit që përfshinë: Akademia për Siguri Publike, Stacionet Policore, Qendra korrektuese në Smrekonicë dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
6. Tarifat e përcaktuara në lidhje me kategorizimet e lart cekura gjenden nënin 9 të kësaj rregulloreje.
7. Operatori ekonomik duhet të bëjë lidhjen e kontratave individuale me kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave të cekura në par. 5 të këtij neni, por që të gjithë gjeneruesit e mbeturinave vlen par. 3 i këtij neni.

Neni 9

Tarifa për mbeturina

1. Tarifa për mbeturina, faturohet dhe inkasohet si në vijim:
 - 1.1 Tarifën për mbeturina e cakton komuna me anë të kësaj rregulloreje;
 - 1.2 Faturimin dhe inkasimin si për ekonomitë familjare, ashtu dhe për bizneset, institucionet publike, OJQ-të dhe institucionet e tjera e bën ndërmarrrja.
2. Tarifa për ekonomitë familjare rezidente caktohet si në vijim:
 - 2.1 Ekonomitë familjare rezidente do të paguajnë shumën në vlerë prej 10.00€ në muaj.
 - 2.2 Ekonomitë familjare jo rezidente do të paguajnë shumën në vlerë prej 40.00€ në vit.
3. Tarifa për bizneset, institucionet publike, OJQ-të dhe institucione të tjera do të përcaktohen si në vijim:
 - 3.1 Nënkatëgoria e parë që përfshinë veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese do të ngarkohet prej 10.00€ në muaj.

- 3.2 Nënkatëgoria e dytë që përfshinë subjekte të mesme dhe të mëdha komerciale dhe industriale me kosto të ulët të shërbimit do të ngarkohet në shumën në vlerë prej 20.00€ në muaj.
- 3.3 Nënkatëgoria e tretë që përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të moderuar të shërbimit, do të ngarkohet në shumën në vlerë prej 25.00€ për muaj.
- 3.4 Nënkatëgoria e katërt që përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale industriale me kosto të lartë të shërbimit do të ngarkohet si në vijim:
- 3.4.1 Për zbrazjen e kontejnerit 1.1 m³ në vlerë prej 14.00€.
- 3.4.1.1 Bizneset me më shumë se një zbrazje të kontejnerëve 1.1 faturohen me 10.00 euro për çdo zbrazje tjetër.
- 3.4.2 Për zbrazjen e kontejnerit 5m³ në vlerë prej 60.00€.
- 3.4.3 Për zbrazjen e kontejnerit 7 m³ në vlerë prej 75.00€.
- 3.4.4 Për asgjësimin e eshtërave do të paguhet shuma në vlerë prej 100.00€ për një muaj.
- 3.5 Institucionet publike, OJQ – të dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit do të ngarkohen në shumën në vlerë prej 10.00€ në muaj.
- 3.6 Institucionet publike, OJQ – të dhe institucionet e tjera me kosto të mesëm të shërbimit do të ngarkohen në shumën në vlerë prej 20.00€ në muaj.
- 3.7 Institucionet publike, OJQ – të dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit do të ngarkohen si në vijim:
- 3.7.1 Për zbrazjen e kontejnerit 1.1 m³ në vlerë prej 14.00€.
- 3.7.2 Për zbrazjen e kontejnerit 7 m³ në vlerë prej 75.00€.
4. Shpërndarja e faturës së mbeturinave bëhet duke u bazuar në sistemin e të dhënave që ka komuna, ku gjeneruesve të mbeturinave do t'u dorëzohet fatura muaj për muaj.
5. Dorëzimi i faturave bëhet në pajtueshmëri me nenin 109 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku dorëzimi do të bëhet përmes postës elektronike apo fizike.
6. Pagesa e tarifës për mbeturina mund të bëhet në arkën e komunës në Qendrën e Shërbimit me Qytetar, ose në institucionet financiare për pagesa, apo në vende të tjera të caktuar nga ana e ndërmarrjes.
7. Gjeneruesit mund të parapaguajnë tarifën për gjashtë (6) muaj ose një (1) vit.
8. Secili gjenerues që banon me qira, është i obliguar të bëjë pagesën për mbeturina në emër personal dhe duhet të regjistrohet në sistemin për menaxhimin e mbeturinave, ose të dëshmojë kontratën e nënshkruar (në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit).
9. Në rast se gjeneruesi i mbeturinave nuk i përmbush obligimet financiare për shërbimet e ofruara brenda afateve të përcaktuara, ofruesi i shërbimit ka të drejtë të iniciojë procedurat e detyrueshme të arkëtimit të borxhit përmes Përmbarrësive Privat.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e operatorit të kontraktuar për shërbimin e mbeturinave

Operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për mbledhjen, transportimin, grumbullimin, riciklimin dhe shërbime të tjera që përfshihen në kuadër të menaxhimit të mbeturinave, janë të obliguar që të veprojnë sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi, të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Neni 11 Veprimet e ndaluara

1. Me këtë rregullore ndalohen veprimet si më poshtë:
 - 1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;
 - 1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë me legjislacionin në fuqi dhe aktet tjera relevante të kësaj fushe;
 - 1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv siç janë; ballkonet, korridoret dhe tarracat e banesave;
 - 1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
 - 1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
 - 1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike si në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike;
 - 1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të përcaktuara për hedhjen e mbeturinave, pa autorizim të autoriteteve komunale dhe ndërmarrjes.
 - 1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, në pikat mbledhëse dhe ndarëse të mbeturinave;
 - 1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët dhe të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
 - 1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”, për të cilët ekzistojnë kontejner dhe kontrata të veçanta;
 - 1.11 Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
 - 1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
 - 1.13 Dërdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve, gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
 - 1.14 Ndalimi i transportimit të mbeturinave, pa mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportimit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
 - 1.15 Ndalohet ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të

mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me kontratë.

1.16 Ndalohet hedhja në kontejnerë ose në afërsi të tyre të mbeturinave nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme.

Neni 12

Dispozitat Ndëshkuese

Ndaj çdo personi fizik ose juridik që ndërmerr veprime me të cilat ndotet mjedisi apo bën shkelje të tjera të parapara me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe plotësim-ndryshimet e tij (Ligji Nr. 08/L-071), do të shqiptohet gjobë mandatare ose do të iniciohet procedurë për kundërvajtje në Gjykatë nga Inspektorët Komunalë ose Policia e Kosovës, konform lartësisë dhe procedurave të përcaktuara në Dispozitat Ndëshkimore të Ligjit në fuqi.

Neni 13

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është edhe shtojca e cila bënë kategorizimin dhe përcaktimin e taksave.
2. Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje ngarkohen dhe autorizohen ekzekutivisht: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Inspektime, si dhe Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" Sh.A. në Vushtrri, secila në dritën e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe me këtë akt.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (KKV) Nr. 05/2020 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë dhe Rregulloren (KKV) Nr. 03/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesues/e i/e Kuvendit Komunal
të Vushtrrisë**



SHTOJCA E RREGULLORES

Nën kategoria e parë – Veprimtaritë e vogla zëjtare dhe shërbyese me pagesë mujore në vlerë prej: 10.00 Euro	Nën kategoria e dytë – Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të ulët të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 15.00 – 20.00Euro	Nën kategoria e tretë - Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të moderuar të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 25.00Euro	Nën kategoria e katërt - Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit me pagesë në vlerë prej: 14.00€ për zbrazje të kontejnerit 1.1m ³ , në vlerë prej 50.00€ për zbrazje të kontejnerit prej 5m ³ , dhe në vlerë prej prej 75.00€ për zbrazje të kontejnerit prej 7m ³	Nën kategoria e pestë Subjektet ekonomike dhe komerciale që ushtrojnë veprimtari të specializuar në trajtimin, përpunimin, si dhe shitjen me shumicë ose pakicë të mishit me pagesë mujore në vlerë prej 100.00€
Kioskat dhe shitoret e dyqanet e madhësisë së ngjashme me të kioskave	Lokalet për shitjen e mjeteve motorike (auto sallonet) dhe mirëmbajtjen e automjeteve (duke përfshirë limarët)	Kafiteritë dhe lokalet e vogla të ushqimit të shpejtë	Dyqanet e mëdha (super marketet) dhe furrat e bukës dhe byrektorët	Mishtoret, pikat e specializuara të shitjes së mishit, njësitë e përpunimit dhe paketimit që hudhin eshtrat.
Shitoret e dyqanet e vogla si: shitësit e kafesë,	Frizerët dhe lokalet e tjera të kujdesit personal	Shitoret ushqimore dhe bodrumet e pijeve	Restorantet (për ahengje familjare, salla dasmesh etj.)	

disqeve, kozmetikës, syzeve, thjerrëzave dhe suvenireve (dhuratave) të vogla	Barnatoret			
Axhustatorët (salduesit)		Zyrat e shërbimeve profesionale me madhësi mbi 20m ² , siç janë: zyrat e avokatëve, noterëve, përbaruesve, këshilltarëve financiarë, dhe bankat	Gjellëtoret	
Argjendaritë	Ordinancat	Sallonet e mëdha të mobilieve	Klubet e natës	
Orëtarët	Klinikat e vogla dhe ambulancat stomatologjike me deri në dy karrige (për mbeturina komunale)	Qendrat sportive	Veprimtaritë hoteliere	
Agjencitë Turistike	Serviset e pajisjeve teknike dhe elektronike	Veprimtaritë zejtare më të rënda si limarët dhe xhamaprerësit	Pompat e benzinës me restorant	
Rrobaqepësit	Shitoret e tekstitit	Spitalet (vetëm sa i përket mbeturinave komunale)	Veprimtari te tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	
Këpucëtarët	Sallonet e sanitarisë	Pompat e benzinës me mini-market		
Fotografët	Qendrat e fitnesit	Ndërmarrjet Publike		
Butikët	Shitoret e vogla përfshirë shitoret sanitare, të mobileve, të auto-pjesëve	Veprimtari të tjera të ngjashme për nga		

		madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë
Libraritë	Shitoret e kqpucwve	
Dyqanet e pastrimit kimik	Veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	
Këmbimoret		
Llamarinë-punuesit		
Zyrat e shërbimeve profesionale deri në 20m ² , siç janë: zyrat e vogla të avokatëve, noterëve, përmbartësve, këshilltarëve financiarë		
Veprimtari të tjera të vogla siç janë: parkingjet, qendrat e video-lojërave dhe kurset e gjuhëve dhe teknologjisë		
Veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë		


Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 10.00€uro	Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të mesme të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 20.00€uro	Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit me pagesë në vlerë prej 14.00€uro për zbrazje të kontejnerit 1.1m ³ dhe në vlerë prej 75.00€uro për zbrazje të kontejnerit 7m ³
Zyrën e Punësimit	Shkollat fillore dhe të mesme Korrik - Gusht	Akademia për Siguri Publike
Agjencioni për Regjistrim Civil	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare	Stacionet Policore
Ambulantet e Mjekësisë familjare	Spitali Regjional Sheikh Zayed – sa i përket mbeturinave komunale	Qendra korrektuese në Smrekonicë
Qendra për Punë Sociale	Halla e Sporteve – Jeton Tërstena – Tota	Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
Zyrat e Partive Politike	Stadiumi i Futbollit – Ferki Aliu	Shkollat fillore dhe të mesme Shtator - Qershor
Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	Stadiumi i Futbollit në fsh. Doberllukë	
	Fakulteti i Sigurisë Publike	
	Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri	
	Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	




Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës Vushtri

Propozuesi :Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi 

Hartuesi: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë , Bedri Dobra 

Lënda: Propozim-Vendim për këmbim të pronave.

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), nenit 24, nenit 25 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 29, 30 dhe 31 të Rregullores (QRK)nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më _____ 2026, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private në Rr. "Ismail Parduzi" në Vushtri sipas gjendjes faktike.

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ariani Company SH.P.K me pronar Naser Imeri.
2. Pronat e paluajtshme që do të këmben kanë këto karakteristika: Pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-6570-0 në sipërfaqe prej 161m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5267m² zk Vushtri pronë e Ariani Company SH.P.K, me pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-1106-1-0, në sipërfaqe prej 161 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3707m² zk Vushtri pronë e Komunës Vushtri. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës- kuqe në rrugën publike në "Gjon Buzuku" bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.
3. Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Departamentit për Vlersimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
4. Pronat e paluajtshme që do të këmben, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

6. Ku vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjet (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuese e Kuvendit

Melihate Basholli-Latifi

ARSYETIM


Kompania Ariani Company SH.P.K me pronar Naser Imeri ka parashtruar kërkesë pran këtij organi me të cilën ka kërkuar këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e tij e cila pronë kufizohet me pronën komunale

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë vërtetohet se parcelat në fjalë gjenden brenda Planit Zhvillimor komunal 2016-2024 dhe se destinimi është brenda Zonës Urbane, pjesa e propozuar për këmbim nga parcelat në fjalë kanë arsyeshmëri pasi që mundëson kyqje dhe zgjerimi i rrugës në fjalë.

Andaj në respektim të Ligjit nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, rregullores (QRK) nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Ligjit nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kemi proceduar kërkesën në fjalë për vlerësimin e këtyre pronave në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe raportin për vlerësimin se komuna nuk posedon pronë tjetër e cila do të mund të këmbetet me pronën private.

Andaj në bazë të dhënave të cekura më lartë konsiderojmë se janë plotësuar kushtet për këmbimin e pronës komunale dhe ju propozojmë për aprovim Kuvendit të komunës së Vushtrisë këtë propozim vendim si në disopzitiv.

Udhëheqësi i Sektorit për Pronë



Azem Bejta

Drejtori i Drejtorisë



Bedri Dobra



Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedistit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministersho Životne Sredine i Prostorngs Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

18/11024

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-01106-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

18-1074/26

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

16.04.2026 - 11:13

Komuna / Opština / Municipality:

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Vushtri / Vushtri / Vushtri

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkthim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70202016-01106-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		3707			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
VAROSH/CETINJSKA	0			



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Pakategorizuar/UncategorizedRoad		3707

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liteni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Vushtrisë	600535001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

18/1073

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-06570-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

18-1073/26

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

16.04.2026 - 11:12

Komuna / Opština / Municipality:

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Vushtri / Vushtri / Vushtri

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkthim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70202016-06570-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land	Urban	5267	00-2004	27.09.2023	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
VAROSH/CETINJSKA	0		27.09.2023	



A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²)
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinско zemljište/Construction land	Oborr/Dvoriste/Back Yard		2860
2	Bujqësore/Pojlopriivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land	1748
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinско zemljište/Construction land	Shëtiqi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		659

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësihtë e adresës Pojednostri adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Bashkë Posedim / Sudrzavina / Co-Possessor	ARIANI COMPANY SH.P.K.	811106972	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		Dëshmorët e Kombit	4/18	LRP.nr.ref:2170/6290/2023 dt.15.05.2023 noter B.Dinaj Vushitri nr.lib.233/23	29.09.2023
Bashkë Posedim / Sudrzavina / Co-Possessor	"ARIANI COMPANY" SH.P.K.	71018903	/ / /		Dëshmorët e Kombit	6/2	LRP.nr.ref:438/1928/2021 dt.12.04.2021 noter B.Dinaj Vushitri nr.lib.166/2021	29.09.2023



Sipërfaqja e propozuar për kembimin në mes Kompanis Ariani Company dhe Komunes së Vushtrri

Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada
Ministria e Mbrojtjes dhe Planifikimit Hapësinor
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES



Komuan e Vushtrri, Zona Kadastrale Vushtrri

Sipërfaqja për ndërrimi nga Komuna tek Ariani Company		Sipërfaqja për ndërrimi nga Ariani Company tek Komuna	
Nr i Parcelës	Sipërfaqja m ²	Nr i Parcelës	Sipërfaqja m ²
1106-0	161	6570-0	161

Nr	Y	X
1	7497838.641	4742535.058
2	7497845.176	4742547.085
3	7497853.133	4742557.766
4	7497855.865	4742562.635
5	7497860.105	4742573.138
6	7497863.625	4742582.323
7	7497867.142	4742593.803



Shpjegues:

- Kufiri kadastral (nga SIKTK-G)
- Gjendja e propozuar
- Pjesa e propozuar per kombi
- Pjesa e propozur per kombim
- Pikat e matura
- Nr. Emri i rrugës

Rilevoi : Geo CODE SH.P.K

Nr. i licences : 73

Data e rilevimit : 09.03.2026





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Dt. 16/04/2026

Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe Hartues: kryesuesja e kuvendit znj. Melihate Basholli-Latifi

Tema: Propozim-vendim

Në bazë të nenit 12.2, shkronja “d” në lidhje me nenin 40.2, shkronja “a” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01. Nr. 209/2022, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më _____ 2026 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN (HARTIMIN) E RREGULLORES PËR PUNËN E KUVENDIT

1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshim-plotësimin (hartimin) e Rregullores për punën e kuvendit, në përbërjen si në vijim:

1.1. **Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e Kuvendit dhe komisionit (PDK);**

1.2. _____, **anëtar/e i/e kuvendit;**

1.3. _____, **anëtar/e i/e kuvendit;**

1.4. _____, **anëtar/e i/e kuvendit dhe**

1.5. _____, **nga zyra ligjore.**

2. Komisioni i cekur në pikën një (1) të këtij vendimi, do të bëjë plotësim-ndryshimin (hartimin) e draftit të kësaj rregulloreje dhe të njëjtën do ta procedojë në kuvend për aprovim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit të cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Ky propozim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores bëhet me qëllim të harmonizimit të saj me legjislacionin aktual në fuqi në Republika e Kosovës, si dhe për të reflektuar nevojat dhe zhvillimet e reja në nivel lokal në Komuna e Vushtrisë.

Që nga miratimi i rregullores ekzistuese, janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi ligje të reja, akte nënligjore dhe udhëzime administrative, të cilat kërkojnë përshtatjen e akteve komunale për të siguruar përputhshmëri juridike dhe zbatim të drejtë të tyre. Mos-harmonizimi i rregullores mund të shkaktojë paqartësi ligjore, vështirësi në zbatim dhe mundësi për interpretime të ndryshme nga zbatuesit e saj.

Me qëllim të fillimit të këtij procesi i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrisë që të marrë vendim për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (hartimin) e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë.

Me respekt!